



Humanitarian Law Center, Kosovë
Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovo
Fond za Humanitarno Pravo, Kosovo



Konsultimet me shoqatat e viktimave Iniciativat dhe instrumentet për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës në ish Jugosllavi

4.10.2008.
Prishtinë, Kosovë

Projekt propozimi i rendit të ditës:

10:00-10:30

Fjalët hyrëse

Moderator: Bekim Blakaj, FDH-Kosovë

Iniciativa për themelimin e Komisionit Rajonal për Përcaktimin e Fakteve për Krimet e Luftës: prezantimi i iniciativës dhe rrjedha e konsultimeve

Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare

Vesna Teršelić, Documenta

Mirsad Tokača, Qendra Hulumtuese Dokumentuese

10:30 – 12:00

Debat rreth iniciativës rajonale dhe mënyrave të tjera të përcaktimit të së vërtetës për krimet e luftës nga këndvështrimi i viktimave

- Nevoja për përcaktimin zyrtar dhe kumtimin publik të fakteve për krimet e luftës;
- Rëndësia e pjesëmarrjes aktive të viktimave dhe të shoqatave të viktimave në procesin e konsultimeve rajonale;
- Mënyrat e angazhimit të viktimave dhe të shoqatave të viktimave në procesin konsultativ;
- Përgatitjet për Forumin e Katërt Rajonal mbi Komisionin Rajonal për Përcaktimin dhe Tregimin e Fakteve për Krimet e Luftës në ish Jugosllavi;

Moderatore: Valdete Idrizi, CBM

12:00 – 12:30	Pauzë
12:30 – 14:00	Debat rreth iniciativës rajonale dhe mënyrave të tjera të përcaktimit të së vërtetës për krimet e luftës nga këndvështrimi i viktimave: vazhdim i debatit
14:00 – 15:00	Fjalët përmbyllëse
15:00	Dreka



Bekim Blakaj: Ju dëshiroj mirëseardhje të gjithëve, në emër të Fondit për të Drejtën Humanitare, zyra në Prishtinë dhe në emër të ‘Community Building’ në Mitrovicë ju uroj mirëseardhje në këtë takim. Sigurisht dua t’i falënderoj shoqatat familjare të viktimave si dhe anëtarët e familjeve të viktimave, Këshillin koordinues të shoqatave si dhe pjesëtarët e familjeve të viktimave. Një falënderim të veçantë dua t’ua bëj zonjave Vesna Tërshelliq nga organizata ‘Dokumenta’, e cila ka fluturuar nga Zagrebi dhe si dhe zonjës Natasha Kandiç me bashkëpunëtorët e saj, e cila gjithashtu ka ardhur nga Beogradi për të marrë pjesë në këto konsultime, gjithashtu dua ta falënderoj edhe kryetarin e komisionit qeveritar për të zhdukurit, zotëri Prenk Zetaj si dhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare nga Zyra për persona të zhdukur dhe Forenzik si dhe nga Komiteti i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Me neve sot janë edhe disa përfaqësues të Organizatave Joqeveritare, Fondacioneve dhe përfaqësuesve nga Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Pakicave, avokatë dhe ekspertë të tjerë, të cilët gjithashtu dua t’i falënderoj për pjesëmarrje në këto konsultime.

Ne sot kemi menduar të kemi konsultime në rend të parë me shoqatat familjare të viktimave në lidhje me iniciativat dhe instrumentet për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës në ish Jugosllavi, këto konsultime janë organizuar në vazhden e dhjetëra konsultimeve tjera që janë organizuar në rajon dhe herën e fundit konsultime të këtilla janë mbajtur në qershor të këtij viti në Mitrovicë. Gjithashtu këto konsultime do të shërbejnë si parapërgatitje për Forumin e Katërt Rajonal i cili do të mbahet më 28 dhe 29 tetor këtu në Prishtinë. Me qëllim që të kemi konsultime sa më konstruktive, ne kemi menduar që formati i këtij takimi të jetë i tillë, me një numër të kufizuar të pjesëmarrësve dhe pa pjesëmarrjen e mediave. Ne kur ju kemi dërguar ftesën për këtë takim, bashkëngjitur me ftesë kemi dërguar edhe disa materiale e ndër to ka qenë edhe Raporti mbi konsultimet e shoqërisë civile deri më tani por unë megjithatë do t’i lus përfaqësuesit e ‘Fondit të së Drejtës Humanitare’, ‘Dokumentës’, përfaqësuesen e ‘Community Building’ Mitrovica që të na flasin diçka më shumë për iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe të bëjnë prezantimin e kësaj iniciative dhe rrjedhën e konsultimeve deri më tani. Meqenëse jemi shumë vonë, unë menjëherë do t’ia jap fjalën zonjës Natasha Kandiç nga Fondi për të Drejtën Humanitare.

Natasha Kandiç: Mirë dita të gjithëve. Sot kam takuar shumë miq të mi, të cilët nuk i kam parë më se dy, tri vite dhe, para fillimit të këtij tubimi, kam marrë disa informata të cilat më bëjnë të besoj më shumë se kjo iniciativë, se ne, në nivelin rajonal, po përpiqemi që të themelojmë një Komision Rajonal, i cili do të merret me përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, se kjo është një iniciativë e rëndësishme, për të cilën duhet të flasim me këmbëngulje, dhe të vijmë gjer te të dhënat precize se çfarë, në të vërtetë ne, duam të arrijmë me këtë iniciativë për Komisionin Rajonal. Njëra nga qështjet më të rëndësishme të pasluftës, jo vetëm në Kosovë por edhe në tërë territorin e ish- Jugosllavisë, është qështja e fatit të personave të zhdukur. Sot, ne, kemi rreth 17.000 raste të pazgjedhura të të zhdukurve. Ju e dini se fati i të zhdukurve nuk zgjedhet në gjykata, se gjersa nuk i kemi ato të dhëna mbi varrezat masive, gjersa ata që dijnë se çka ka ndodhur me njerëzit që janë burgosur dhe dërguar dikah, e dini se ai fat i tyre do të mbetet i pazgjedhur, por nuk ka gjykatë e cila është marrë me atë qështje, dhe e cila ka zgjedhur fatin e të zhdukurve. Përvojat e disa shoqërive, siq është ajo e Marokos, na tregojnë se kjo qështje e të zhdukurve mund të zgjedhet në mënyrë efikase, se familjet mund të kuptojnë se

ku janë varrosur mbetjet mortore të më të afërmve të tyre dhe se shoqëria mund të vij gjer te të dhënat mbi përgjegjësinë për fatin e të zhdukurve. Në Maroko ka qenë themeluar Komisioni për barabarësi dhe pajtim, dhe theksi dhe detyra kryesore e atij komisioni ka qenë që të zgjedh fatin e personave të zhdukur. Në afatin dyvjeçar, aq sa ka zgjat mandati, Komisioni ka arritur të zgjedh një numër të madh të rasteve të të zhdukurve. Unë po e cek këtë rast të komisionit maroken, pasi që fati i të zhdukurve pas çdo lufte, mbetet qështja më e vështirë. Dhe, siq po e shihni, në rastin e ish-Jugosllavisë, dhe në rastin e Kosovës, viteve të fundit, ne kemi patur numër gjithnjë e më të vogël të identifikimit, zbulimit të varrezave masive si dhe zbardhjes së fatit të të zhdukurve. Neve na nevojitet një model, një mënyrë, dhe në këtë rast, organizatat joqeveritare kanë ardhur gjer te iniciativa për themelimin e komisionit rajonal, e cila fuqinë e vet do ta ketë në atë, se pas saj do të qëndrojnë shoqatat e viktimave, familjarët e viktimave, organizatat për të drejtat njerëzore, organizatat ndërkombëtare; të cilat gjatë tërë viteve të kaluara i janë përkushtuar shumë qështjes të të zhdukurve, siq janë Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), siq është Kryqi I Kuq Ndërkombëtarë, të cilat do të ndihmojnë dhe përkrahin me diturinë dhe përvojën e tyre, themelimin e komisionit e cila do të ketë fuqinë për të zgjedhur fatin e të zhdukurve dhe që, përfundimisht, t'i vëj pikën kësaj trashëgimie më të dhembshme të luftërave dhe, që thjeshtë, të sjellë një prehje për familjarët e viktimave. Ekziston një grup i tërë njerëzish nga e gjithë ish- Jugosllavia, e cila, kur Tribunali i Hagës ka filluar gjykoj, ka filluar të mendoj se çfarë mund të sjellë ai Tribunal i Hagës. Ata njerëz kanë qenë në vende të ndryshme, disa në Kroaci, Serbi, Bosnë e Hercegovinë dhe në Kosovë, të cilët kanë përcjellë punën e Tribunalit të Hagës dhe kanë ardhur në përfundim se, e më vonë edhe kanë patur rast që t'i shkëmbejnë ato konkludimet e veta, ato frikat dhe dyshimet se çka do të dalë prej asaj, se Tribunali I Hagës do të mund të gjykoj vetëm një numër të vogël të njerëzve, por që do të krijoj një dokumentacion të gjërë, i cili do të jetë i rëndësishëm për të krijuar një fotografi të plotë për atë se çka ka ndodhur në ato luftëra. Këta janë, për shembull, Refik Hoxhiq, nga Bosna dhe Hercegovina, i cili ka punuar në Tribunalin e Hagës për një kohë si zëdhënës dhe ka udhëhequr Zyren e Prokurorisë së Hagës në Sarajevë, Hysni Berisha I cili ka dëshmuar në Hagë, gjithashtu, disa nga ne në Serbi kemi menduar njëjtë, Vesna Tershelliq, Ivan Zvonimir Çiçak në Kroaci, kemi menduar se si të dalim në skaj me faktin se as një gjykatë, as të gjitha gjykatat së bashku- Tribunali I Hagës dhe gjykatat vendore së bashku- nuk do të mund të sjellin para drejtësisë ndonjë numër më të madh të atyre që kanë kryer krime lufte. Sepse proceset gjyqësore zgjasin shumë, para procesit gjyqësor kemi hetime të cilat zgjasin shumë dhe bëhen larg syve të opinionit. Në histori, asnjë gjykatë nuk ka patur sukses që para drejtësisë të sjell as edhe të gjithë kryerësit e një ngjarjeje konkrete masive, por gjithnjë vetëm një numër të vogël të tyre. Kjo do të thotë se ne, pas 20 apo 30 vitesh, në tërë territorin e ish-Jugosllavisë do të mund të kishim mes 1200 dhe 1500 të atyre që kanë qenë të akuzuar dhe dënuar për krime lufte, që do të thotë se shumica e tyre do të mbeten të pazbuluar, dhe opinionit dhe gjeneratat e ardhshme nuk do të dijnë se kush i ka kryer krimet e luftës, ku kanë ndodhur ato; por në çdo vend, do të shkruhet për atë se çka ka ndodhur, varësisht prej asaj se sa ka mundur ajo shoqëri të paraqes, ofroj. Mu kjo na ka bërë që të mendojmë për atë se, ne, në këto treva, kemi obligim ndaj familjeve të viktimave, para së gjithash, e pastaj ndaj gjeneratave të ardhshme, që kjo trashëgimi, e shenjuar me krime, t'iu dorëzohet, t'iu lihet në formë të fakteve, që t'a dijmë se çka ka ndodhur në Lluzhan/ Lužane, në urë, kur NATO gjatë bombardimit, ka qëlluar një autobus, si ka ndodhur që anëtarët e familjes Ramadani kanë përfunduar në varrezat e fshehta masive në Serbi, si janë kryer... As sot, ne nuk e dijmë se si është bërë bartja

e trupave nga Kosova në Serbi dhe si kanë kaluar pranë nesh ata kamiona me trupa e ne, nuk i kemi parë gjer në momentin kur një nga kamionët frigorifer nuk ka rënë në lum... Në të vërtetë, as atëherë nuk u kuptua për këtë, por vetëm pas ndërrimit të qeverisë u muarr vesh për këtë kamion frigorifer. Ekzistojnë shumë gjëra të cilat i dijnë vetëm familjet dhe shoqatat por jo edhe opinioni. Neve po na nevojitet një trup i cili, në mënyrë shumë të organizuar, do të shfrytëzonte dokumentacionin e mbledhur nga Tribunali i Hagës, të organizonte hetimin shtesë lidhur me numrin e madh të rasteve me të cilat, as Tribunali i Hagës e as gjykatat vendore, nuk janë marrë, të krijoj hartën e krimeve të luftës, të jap një fotografi të asaj se çka ka ndodhur, e, në të njëjtën kohë, në këtë mënyrë do të ndihmonte edhe prokuroritë, por edhe ajo, që është me shumë rëndësi, është që të krijoj një pasqyrë të plotë për krimet e luftës, të krijoj klimën në të cilën do të zhvillohej solidariteti dhe bashkëndjenja me viktimat, si dhe të krijohej një platform publike ku viktimat do të mund të flasin për ato që u ka ndodhur. Familjet e viktimave ende janë viktimat, e drejta e tyre themelore është që të dijnë se çka ka ndodhur me anëtarët e tyre të familjeve, në çfarë mënyre janë vrarë, në çfarë kushte janë zhdukur, kush është përgjegjës për atë, dhe, edhe sot e kësaj dite nuk kemi përgjigje për këto. E këto janë disa nga të drejtat të cilat u takojnë viktimave sipas të gjitha marëveshjeve ndërkombëtare, dhe jetësimi i tyre është obligim i të gjitha shteteve. Shteti është i detyruar që këto informata t'ua përcjellë familjarëve të të zhdukurve por edhe vetë shoqërisë. Ne e kemi vërejtur se familjeve të viktimave, me kalimin e viteve, po u vie gjithnjë e më e rëndë edhe kjo indiferencë në secilën shoqëri. Unë vetëm do t'ua përkujtoj se këtu, në Kosovë, në vitin 1999 ka patur shumë organizata ndërkombëtare dhe gazetarë, të gjithë kanë qenë të interesuar të dijnë se çfarë ka ndodhur, ka patur shumë rrëfime individuale se çka i ka ndodhur Ukshin Hotit, se çka ka ndodhur në Korenicë/ Korenici, në Mejë/ Meji, çka ka ndodhur në Vushtrri/ Vuçitru; po ashtu siq kanë kaluar vitet, edhe ato gjithashtu, janë bërë gjithnjë e më të pakta dhe ne sot e kemi atë që, vetëm, njëherë në vit, të përmendet se si është zhdukur dhe kur është parë për herë të fundit Fehmi Agani, e ne, faktikisht, as sot e kësaj dite nuk e dijmë të vërtetën, nuk kemi fakte për atë se çfarë ka ndodhur atë ditë kur ka udhëtuar Fehmi Agani, kur ka dashur që të largohet nga Kosova për t'i ndihmuar liderit kosovar, Rugovës, në marrëdhënjet me bashkësinë ndërkombëtare rreth shpërnguljes, deportimit dhe krimeve, të cilat janë kryer në atë kohë në Kosovë. Dhe ngadalë ai... të menduarit e parreshtur se ajo po na nevojitet, ajo ide e ka fituar një promovim publik, e sidomos, e kemi patur parasysh atë nevojën e viktimave që të flasin dhe të shohin se të tjerët po i dëgjojnë dhe janë të rëndësishëm për ta. Ne e kemi parë këtë qysh në Forumin e Parë Rajonal, të cilin e ka organizuar Fondi për të drejtën humanitare, Qendra për hulumtim dhe dokumentim dhe Documenta, në majin e vitit 2006, në Sarajevë. Në atë Forum kanë marrë pjesë edhe njerëz nga Kosova, të cilët tash mund të flasin për të, dhe ata, ashtu si edhe të gjithë ne, kanë para vetes plotë dy vite e gjysmë përvojë me veprimtarinë rreth kësaj iniciative, dhe kanë një pasqyrë të përafërt se si njerëzit reagojnë në atë, dhe sa kemi arritur të përfitojmë dhe t'i bëjmë të besojnë (kthejnë besimin), jo vetëm familjarët e viktimave por edhe qytetarët tjerë, nëse është e domosdoshme. Pas Forumit të mbajtur në Sarajevë, kemi mbajtur Forumin e dytë në Zagreb, në shkurt të vitit 2007. Kemi mbajtur një numër të madh konsultimesh në grupe të vogla, duke patur parasysh se, krahas Forumit, ku sipas rregullës do të duhej të marrin pjesë 300- 4000 pjesëmarrës, na nevojiten konsultimet me grupe të ndryshme në shoqërinë civile, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit në ato konsultime të ketë mundësi të flas. E mandej kemi organizuar konsultimet e nivelit rajonal me artistët, e kemi patur mundësi të dëgjojmë një njeri, siq është Dino Mustafiq, njërin nga regjisorët më të njohur të Bosnës e

Hercegovinës, po edhe të Ballkanit, Haris Pashoviqin, aty ka patur edhe artistë nga Kosova. Pastaj kemi biseduar me organizata të ndryshme të të rinjëve- nga Bosna e Hercegovina, nga Kroacia, e kemi biseduar edhe me shoqatat e viktimave. Njëra ndër konsultimet më të mira, ka qenë ajo në maj të vitit 2008, në Podgoricë, konsultimet me shoqatat dhe përfaqësuesit e shoqatave të viktimave dhe ky ka qenë konsultim ku pjesëmarrësit, qoftë viktimat apo përfaqësuesit e shoqatave, kanë treguar në mënyrën më të mirë, se përse është e rëndësishme që të ekzistoj një platformë publike për zërin e viktimave ku ata do të mund të flasin për atë se çfarë u ka ndodhur, të flasin me zërin e tyre (të flasin vetë personalisht) dhe të mund të shikojnë në fytyrat e atyre që po i dëgjojnë se çka po flasin. Përse është kjo e rëndësishme? Sepse ata, në tërë këtë shikojnë si në një qështje dinjiteti, njohje (pranim) të vuajtjeve dhe padrejtësisë e cila iu është bërë. Ato konsultime në Podgoricë, gjithashtu kanë treguar se gjer te kjo njohje arrihet vetëm nëse dëgjojmë, se viktimat nuk janë të barabarta (njëllojta) mes tyre dhe se nuk mund t'i barazojmë viktimat (gjeneralizojmë), por e rëndësishme është se mund të barazohemi në vëmendjen tonë për dëgjimin e tyre. Viktimat e gjenocidit, viktimat e deportacionit (shpërnguljes) dhe të përndjekjeve masive nuk mund të barazohen me disa viktime tjera. Për këtë ekziston e drejta ndërkombëtare e cila shumë qartë e definon dhe përshekruan veprimin ndaj të akuzuarve si dhe kualifikimin e veprës në raport me të akuzuarin, varësisht nga lloji, kategoria e krimit të kryer, respektivisht, krimit të luftës. Do të thotë, ne nuk përfaqësojmë qëndrimin se të gjitha viktimat duhet barazuar, por , ne përfaqësojmë qëndrimin se zëri i viktimave duhet të dëgjohej dhe se është e rëndësishme që të fillohet nga fillimi, të krijojmë një fotografi mbi atë se çka ka ndodhur, të dijmë kronologjikisht se si e gjithë kjo ka ecur dhe atëherë të lëjmë një fushë të madhe me fakte dhe të dhëna, të cilat do të tregojnë se ku gjenden dhe kush janë ata kryerës të krimeve. Në ato konsultime dhe konkludime, gjithashtu, erdhëm gjer të ajo se nuk mund të pohojmë dhe mendojmë se është e saktë ajo që disa politikan duan të thojnë se krimet janë kryer nga individët. Nuk ka asnjë rast në histori ku individët, po edhe mijëra e mijëra individë të kenë veshur uniforma, të jenë armatosur , të kenë marrë automjete të ndryshme speciale e të nisen kundër të tjerëve. Pas këtyre masave gjithnjë kanë qëndruar institucionet dhe shteti i caktuar. Kështu që, në të vërtetë, ajo fotografia jonë e krimeve konkrete të luftës, do të tregoj edhe atë se kush ka qëndruar pas tyre, se kush i ka organizuar kryerësit e drejtëpërdrejtë të bëjnë krimet më brutale e më të tmerrshme. Pas dy vite e gjysmë, unë do të thoja, ne jemi ende në fillim të bisedimeve se si do të duhej të ishte ky komision. Duhet të kemi kujdes se lufta e cila ka filluar në Kroaci, se Serbia është ajo e cila e ka filluar atë luftë, ish Armata Popullore e Jugosllavisë, se lufta nuk është zhvilluar në territorin e Serbisë po në territorin e Kroacisë. Se Serbia, mandej, me formacionet e saja ka marrë pjesë në luftën në Bosnë e Hercegovinë, e mandej, më 1999, formacionet e armatosura, forcat e armatosura, gjë që përfaqësojnë institucionet, kanë luftuar kundër popullatës civile në Kosovë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka shkuar askund jashtë kufinjëve të Kosovës, nuk ka qenë në Bosnë e Hercegovinë, nuk ka qenë në Kroaci, po ka qenë aty ku kanë jetuar dhe ku gjenden shtëpitë e tyre. Domethënë ekziston një shkallë e ndryshueshme e pjesëmarrjes së disa forcave në disa luftëra, konflikte të armatosura dhe në këtë aspekt, konsultimet e sotme dhe ato të ardhmet duhet të na ndihmojnë të shohim se në çfarë mënyre do t'i zgjidh komisioni i ardhshëm. Tani për tani, ne mendojmë se, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ky Komision Rajonal të ketë zyren qendrore dhe që në çdo shtet-trashëgues të ish- Jugosllavisë të ketë zyren nacionale e cila do të merret me mbledhjen e të gjitha fakteve dhe të organizoj marrjen e deklaratave në kuadër të shtetit të vet. Ky komision qendror, me shërbimin qendror hetues, atëherë do të

bashkonte të gjitha ato dhe do të krijonte një pasqyrë të tyre. Në këtë moment, a duhet që ne të shkojmë më përpara, jashtë diskutimeve të shoqërisë civile, e kjo është bisedat me shoqatat e viktimave, me organizatat e të drejtave njerëzore, organizatat joqeveritare që merren me qështjet e demokracisë dhe avancimin (përmirësimin) e pushtetit lokal, mandej me organizatat e të rinjëve, me grupet profesionale siq janë sociologët, historianët, juristët. A duhet, e nëse po, atëherë, në cilin moment duhet ne të dalim para politikanëve dhe institucioneve? Ne kemi filluar me këtë iniciativë sipas modelit (shembullit) të disa organizatave për të drejtat e njeriut apo lëvizjeve për të drejtat njerëzore në shtetet tjera. Ato, së pari kanë mbajtur konsultime në kuadër të shoqërisë civile, kanë fituar përkrahje të fortë e mandej me atë përkrahje të shoqërisë civile, në të cilën rol të madh kanë luajtur shoqatat e viktimave, viktimat dhe organizatat për të drejtat njerëzore, mandej kanë përpiluar rekomandimet dhe kanë shkuar tek qeveritë. Iniciativa jonë përbëhet prej mendimit tonë se ne duhet të jetësojmë konsultime shumë të gjëra në kuadrin e shoqërisë civile dhe se ato duhet të përfundojnë në atë mënyrë që do të organizojmë mbledhjen e “një milion nënshkrimesh” në të gjitha shtetet e ish- Jugosllavisë, dhe të fitojmë përkrahjen e institucioneve europiane, KB, anëtareve të BE, organizatave profesionale ndërkombëtare, si janë ICMP dhe MKCK, organizatave ndërkombëtare joqeveritare siq është Human Rights Watch, Amnesty International, Mjekët pa kufinj dhe mandej të shkojmë tek qeveritë nacionale (kombëtare) dhe të kërkojmë nga ato që të ndërmarrin atë proces të themelimit të Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave njerëzore. Domethënë, atë Komision Rajonal, nuk do ta temelonim as ne , e as shhoqatat e viktimave, e as organizatat për të drejtat e njeriut, sepse ai komision duhet të ketë fuqi institucionale e atë fuqi mund t’ia japin vetëm qeveria dhe parlamenti. Ne mund të përgadisim të gjitha kushtet për themelimin e atij komisioni, por procesin duhet ta udhëheqin vetë qeveritë. Dhe, sot, ne këtu, duam që të bisedojmë dhe secili nga ju le të përpiket të mendojë për atë, të përpiket të shoh një të ardhme... Pas një kohe, kur ne më nuk do të jemi këtu që të flasim në këtë mënyrë për këtë, për nja 100 vite, çka do të jetë me rëndësi? Me rëndësi do të jetë se do të ekziston diçka që janë faktet, diçka që në mënyrë të qartë do t’i tregoj atyre gjeneratave të reja se çka ka ndodhur këtu. Gjithashtu duhet patur parasysh atë se famijeve të këtyre 17.000 viktimave, ne duhet t’iu mundësojmë që të vijnë gjer te mbetjet mortore të të afërmeve të tyre. Nuk mund ta lëjmë këtë dhe të themi “ kanë kaluar nëntë vite, ta harrojmë atë që ka ndodhur “. Ndoshta nuk mundemi që të gjithë ne, që jemi prezent këtu, të vendosemi në atë pozitë se çka domethënë të shkosh nga njëra varrezë masive në tjetrën, të presësh për ndonjë të dhënë, të shpresosh se dikush do ta zgjedh atë qështje dhe të thotë “ ja këtu e këtu gjenden eshtrat “. Ky është një obligim, obligim i shoqërisë, obligim i institucioneve, e ne mundemi vetëm të bëjmë presion. Dhe nëse bëjmë presion më tepër, aq më të mëdha do të jenë mundësitë që të vihet gjer te të dhënat për varrezat masive. Unë jam e sigurtë që në Serbi ka ende varreza të fshehta masive. Këtu në komorat-frigoriferë në Prishtinë/ Prištini gjenden trupat e edhe rreth 300 njerëzve. Çfarë po ndodh me të tjerët? Ku gjenden ata? Ne duhet të dijmë. A është e vërtetë se janë djegur trupat e njerëzve në Obiliq/ Obiliću? Ne duhet të dijmë se cila është e vërteta për furrat e larta në fabrikën Maçkatica? Nëse heshtim, nëse themi “ Ne nuk duam bashkë“, nëse serbët dhe shqiptarët nuk duan bashkë, nëse boshnjakët nuk janë të interesuar të kuptojnë se çfarë ka ndodhur në fabrikën Maçkatica, atëherë të gjithë së bashku do të ndihmojmë që gjërat të mbeten ashtu siq janë dhe të mos arrihet të zbardhen fatet e të zhdukurve. Por, nëse jemi bashkë, sikurse që arrijtëm që në forumet dhe konsultimet në Podgoricë që familjarët e viktimave të ulen së bashku dhe

kuptojnë se çka do të thotë të mos dihet se kush është djegur në fabrikë, në Maçkaticë... Dua të them se ne duhet ta kemi atë qëndrim minimal, të përbashkët ndaj të së kaluarës për hir të obligimit ndaj familjeve të viktimave dhe obligimit ndaj të së ardhmes. Unë jam përpjekur të krijoj një fotografi për atë moment kur disa njerëz kanë filluar të mendojnë se përse janë aq të rëndësishme faktet dhe të mos i presin gjykatat, gjer në momentin ku, po me duket se, tash jemi, në një fazë që kemi përkrahjen e shoqërisë civile vetëm se tash duhet të shkojmë në mënyrë shumë më të organizuar me këto konsultime që në fund të vitit të ardhshëm të jemi në gjendje të kërkojmë dhe presim nga qeveritë e Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Kosovës që ato të pranojnë këtë iniciativë për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve. Shpresoj se kam arritur që të ju tregoj dhe sqaroj së paku një pjesë të asaj se çka ka ndodhur dhe mënyrën se si ka ndodhur. Lus Vesnën që ajo tash të ju flas mbi atë se si ne tani veq kemi arritur sukses që të mbërrijmë gjer te ajo, që iniciativa më të mos i takojë asnjë organizate por e kemi krijuar koalicionin. Në këtë koalicion tashmë gjenden organizatat të cilat që nga fillimi, që nga maji i vitit 2006, dhe ajo që duam në forumin e Prishtinës, më 28 Tetor, është ta paraqesim këtë iniciativë edhe në konferencën për shtyp, ta paraqesim atë fakt se është themeluar Koalicioni Rajonal për themelimin e KOMRA-s, KOMRA është shkurtësë për emrin e propozuar të komisionit. Në gjuhën shqipe është KOMRA (serbisht REKOM). Do të thotë , po flasim për diçka që nuk është pronë e Fondit për të Drejtën Humanitare, por e tërë iniciativa i takon Koalicionit për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve për krime të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtës njerëzore.

Bekim Blakaj: Tani fjalën do ia jap zonjës Vesna Tershelliq nga organizata 'Dokumenta' prej Zagrebit, organizatë që ka qenë një ndër organizatoret e këtij procesi.

Vesna Tershelliq: Ju falenderoj. Mirëdita të gjithëve. Gjithnjë me kënaqësi kthehem në Prishtinë. Këtu kam filluar të vij që në vitet e tetëdhjeta, kështu që e di se sa vështirë ka qenë në Kosovë dhe, konsideroj se, nuk është rastësi që Koalicioni ynë i ardhshëm dhe kjo iniciativë do të formalizohet mu në Kosovë, dhe më vie mirë që më 28 dhe 29 tetor, do të arrijmë momentin e nënshkrimit dhe formalizimit të kësaj iniciative të cilën e kemi filluar në maj 2006, në Forumin në Sarajevë. Javën e shkuar, jam dëgjuar me shumë kolegë, jam dëgjuar me familjarët e të zhdukurve në Vukovar, e kemi lutur Mirko Kovaçiqin(Shoqata *Nënat e Vukovarit*) që të vinte edhe sot këtu me ne, ashtu si erdhi edhe në Mitrovicë, para disa muajsh, jam dëgjuar me familjarët e të zhdukurve në Kroaci dhe në anën kroate të luftës në Kroaci, edhe në anën serbe të luftës në Kroaci ku edhe sot, 17 vite pas fillimit të luftës, kërkohen më se 2000 persona të zhdukur, më se 1000 në anën kroate në Kroaci dhe më se 900 në anën serbe në Kroaci, dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm se sa komplekse është pasqyra e luftës. Gjithashtu jemi të vetëdijshëm se sa munden dhe sa jo gjykatat, sa munden prokurorët, sa mundet policia si trup hetues, sepse nga 703 raste kriminele të cilat janë lajmëruar në Prokurorinë Shtetërore, në trupin akuzues të Kroacisë, gjatë tërë kësaj kohe janë hetuar vetëm më pak se gjysma. Dhe e kemi tërësisht të qartë se në qoftë se ne e presim drejtësinë vetëm nga gjykatat, nga njëra anë nuk do të vërtetohet as çka ka ndodhur me të zhdukurit e fatkeqësisht nuk do të mundemi as për së afërmi të emërtojmë të dyshuarit, nuk do të vijmë as gjer te përshkrimi i fakteve mbi krimin e luftës, e mu për këtë e kemi inicuar bisedën se cila do të ishte mënyra rajonale e mundur për përcaktimin e fakteve. Këtë iniciativën tonë, familjarët e viktimave nuk e kanë parë me besim të madh, posaqërisht ky ka qenë rasti me Kroacinë, gjë që edhe është parë në Forumin e dytë në shkurt të vitit 2007, i cili është mbajtur në Zagreb,

sepse në të njëjtën kohë kemi patur dëshmime në Forum e mandej, pas dëshmimeve, veteranët dhe familjarët e të zhdukurve kanë ardhur brenda dhe biseduar mbi atë se cila do të ishte mënyra më e mirë për të plotësuar atë që po bën gjykata, sepse e kanë parë se numri i gjykimeve është shumë i kufizuar. Në Kroaci, për një vit kemi mes 25 dhe 30 gjykime për krime të luftës e sa shumë e shumë viktima dhe krime kemi. Duke hulumtuar për mënyrën më të mirë të të biseduarit mbi atë se çfarë ka ndodhur, dhe ndërtoam mënyrën më të mirë të përcaktimit të fakteve, në përvojën e organizatave tona si dhe në përvojën e shoqatave të viktimave; dhe jemi përpjekur që të kyqim edhe ata të cilët kanë qenë aktiv, kanë marrë pjesë në luftë, edhe veteranët, edhe mbrojtësit dhe disa veteranë, si në Kroaci ashtu edhe në Bosnë dhe Hercegovinë na janë bashkangjitur. Na janë bashkangjitur edhe disa organizata për të drejtat e njeriut, disa organizata të grave, kurse edhe disa politikan dhe politikane kanë shprehur interesim për këtë. Dua të ju them se edhe në fillim të këtij procesi, qysh në vitin 2006, kur e kemi mbajtur Forumin në Sarajevë, mua më është dukur se më e vështira do të jetë për të përfituar përkrahjen për një komision të këtillë rajonal, mu në Kroaci. Dhe shumë gjëra kanë ndryshuar. Më duhet të ju them se, me sa më kujtohet, mu politikani i parë që ka përkrahur këtë, edhe ka qenë nga Kroacia. Sikur të më kishin pyetur në vitin 2006, se a do të ishte kjo e mundur, unë do të thoja “ jo, politikanët kroat janë të fundit që do ta përkrahnin këtë “, e sot po më duket se edhe Stjepan Mesiçi do të mund ta përkrahte këtë iniciativë. E kemi shumë të qartë se, poqese, kjo iniciativë mbetet diq që e përkrahim vetëm ne nga shoqëria civile, organizatat për të drejtat e njeriut, shoqatat e viktimave dhe organizatat e grave e të veteranëve, atëherë kjo nuk do të ketë sukses, në rast se nuk e fiton edhe përkrahjen e qeverive. Dhe është shumë e rëndësishme se çfarë do të thonë kryetarët, çfarë do të thonë kryeministrat, çfarë do të thonë partitë politike, dhe për këtë ky forum në Kosovë ka rëndësi shumë të madhe, edhe kjo bisedë me ju është shumë e rëndësishme, sepse jam e sigurt që keni shumë dilema dhe shumë pyetje, të cilat ju kanë rënë ndërmend edhe para se të vini këtu apo keni edhe të reja, shtesë gjer sa i dëgjoni këto fjalët hyrëse. Mendoj edhe në qoftë se sot nuk do të ketë përkrahje, në Kosovë ose në ndonjë vend tjetër, se kjo situatë mund të ndërroj relativisht shpejtë. Për mua është shumë interesante se si ajo situatë ndryshoi në Kroaci dhe mendoj se mu bisedat që nga viti 2006 e gjer më sot kanë kontribuar, të themi, që familjarët e viktimave në Kroaci, të cilët na janë afruar me shumë mosbesim, të shohin se në opinion temat për përcaktimin e fakteve, temat për përcaktimin e së vërtetës po marginalizohen gjithnjë e më shumë, se pa marrë parasysh atë që faktet nuk janë përcaktuar, që e vërteta nuk është treguar në opinionin Kroat, gjithnjë e më pak njerëz po shprehin interes për atë dhe se është shumë me rëndësi të kërkojmë aleancë me ata të cilët në vitet e nëntëdhjeta e ca, ndoshta na kanë parë si tradhtarë (transkript). Me disa njerëz nga organizatat e familjarëve të të zhdukurve po komunikoj qysh nga vitet e nëntëdhjeta dhe mu me ata që nuk i kanë dashur disa gjëra që i kanë bërë organizatat për të drejtat e njeriut në vitet e nëntëdhjeta, ja sot, po punojmë së bashku në kontekstin e kësaj iniciative pa marrë parasysh se edhe ka disa gjëra rreth të cilave nuk pajtohemi, por jemi të gatshëm të dëgjojmë njëri tjetrin dhe shikojm si të gjejmë mënyrën si të punojmë në rrugën e përbashkët për përcaktimin e fakteve si dhe prezentimin e gjithë asaj që ka ndodhur në opinion dhe në krijimin e hapësirës për zërin e viktimave në opinion; as televizioni publik e as mediat e shkruara më nuk po tregojnë interesim të mjaftueshëm për atë se çka ka ndodhur. Ndoshta kjo në Kosovë nuk është ende aq akute, por në Kroaci, sidoqoftë, kanë kaluar 17 vite që nga fillimi i luftës dhe është parë se për çështjen e të zhdukurve më së tepërmi po interesohen vetëm familjarët, veteranët dhe organizatat për të drejtat njerëzore, dhe e kemi shumë të rëndësishme të bashkëpunojmë si në

përkrahjen e gjykimeve për krime të luftës ashtu edhe për përkrahjen e kësaj iniciative. Disa nga ju ndoshta do të pyesin “pse iniciativa rajonale, pse nuk po fokusohemi në luftën në vende të caktuara”? Ekzistojnë shumë arsye, por tash dua të përmend vetëm atë se viktimat sot janë në një vend, e kryerësit e krimeve në një vend tjetër. Për Kroacinë kjo do të thotë se viktimat nga ana kroate janë në Kroaci e viktimat serbe në Serbi, e kryerësit janë në Serbi dhe Bosnjë e Hercegovinë, çka edhe shohim në gjykimet për krime lufte, çka me anën e bashkëpunimit rajonal prap tash, pa marrë parasysh se kryerësit e disa krimeve në Serbi, disa gjykime po mbahen pos Kroacisë edhe në Serbi; nga ana tjetër edhe fakti që viktimat gjenden në vende të ndryshme do të thotë se nëse duam të dëgjojmë më tepër për faktet dhe interpretimet duhet t’i dëgjojmë edhe ata që sot më nuk jetojnë në Kroaci. Natyra e luftës në Kroaci është komplekse dhe, siq është edhe evidente, Kroacia ka qenë e sulmuar dhe në krye të listës së përgjegjësive janë Millosheviqi dhe Qeveria e Serbisë, shihet qartë se lufta në Kroaci, përpos që ishte luftë mbrojtëse, kishte edhe elemente të luftës qytetare. Për këtë edhe kemi viktimë edhe në njërin anë edhe në anën tjetër të luftës, dhe për këtë disa viktimë edhe nuk jetojnë tani në Kroaci, pasi që kanë ikur të shumtën në vitin 1995 në muajt maj dhe gusht. Mendoj se është shumë me rëndësi edhe për shkak të përgjegjësisë që kemi ndaj të mbijetuarve dhe të gjithë të tjerëve në shoqërinë tonë, shumë është me rëndësi që të përcaktohen faktet e këto fakte janë aq komplekse sa që mund të përshkrohen vetëm në kontekst rajonal. Ne, në Kroaci thjeshtë nuk mund të dijmë dhe nuk mund të shohim të gjitha ato që kanë ndodhur me ata të cilët kanë ikur pas akcionit ushtarak Rrufeja në gusht të vitit 1995, nëse ata nuk jetojnë më në Kroaci, e shumica jetojnë në Bosnjë e Hercegovinë. Për këtë, gjatë këtij procesi të gjatë të konsultimeve, kemi vendosur që të përkrahim këtë iniciativë të përbashkët dhe ta dorëzojmë tek pushteti formal në nivel presidencial, të kryeministrit dhe parlamenteve në vendet tona dhe të fillojmë negociatat me ta, në mënyrë që të shohim cilat janë mundësitë modale për të themeluar këtë komision. Për më pak se një muaj, këtu me ne do të jenë edhe miqtë nga Srebrenica, Sarajeva, Prijedor, nga Pakraci, domethënë ata të cilët drejtëpërdrejtë kanë pësuar nga luftërat në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, që të japin së bashku përkrahjen e tyre për këtë iniciativë, dhe për ta dërguar tek institucionet zyrtare. Natyrisht, ne nuk mund të dijmë se si do të jetë reagimi i tyre, as që mendoj se është e rëndësishme që të ngarkohemi me këtë në mënyrën e cila do të mund të dobësonte këtë iniciativë. Me rëndësi është se jemi të vetëdijshëm se do të ekzistojë problemi dhe atëherë duhet të mendojmë për mënyrat konstruktive me të cilat më vonë do të bisedojmë me ta. Më e keqja do të ishte kur paraprakisht do të thoshim “ata me siguri do të thojnë jo”, se une jam e sigurtë se në mesin e politikanëve të cilët udhëheqin vendet tona, ka edhe të tillë të cilët edhe do të thonë “shumë iniciativë interesante, duhet të flasim për këtë dhe ta zhvillojmë më tutje”. Dhe më vie mirë që në Kroaci mund të llogarisim se për këtë do të ketë mirëkuptim kryetari Mesiq, e mandej do të shohim se si t’ua afirmojmë dhe si t’ua prezentojmë të tjerëve. Unë shpresoj që shumicën nga ju apo të gjithë juve, e edhe më shumë njerëz, të shoh në forum në Prishtinë/Prištini. Po e jap fjalën, Valdete.

Bekim Blakaj: Unë dua vetëm të ju informoj sepse në programin që e keni marrë ju si panelist ka qenë i paraparë edhe zotëri Mirsad Tokaqa nga Qendra Dokumentuese Hulumentuese në Sarajevë, organizatë e cila gjithashtu ka qenë iniciatore e këtij procesi, por për shkaqe objektive nuk ka mundur të udhëtojë në Prishtinë. Gjithsesi unë do ta ftoj zonjën – zonjushën Valdete Idrizi nga ‘Community Building’ Mitrovica, bashkëorganizatore e këtij takimi dhe ajo organizatë tanimë është futur në këtë proces, është bartëse e procesit, Valdete urdhëroni:

Valdete Idrizi : Faleminderit Bekim! Pra paraprkisht dëshiroj të ju përshtëndes të gjithëve, jam pra Valdete Idrizi, vij prej Mitrovicës prej organizatës së CBM, e cila është aktive afër tetë vjet në regjionin e Mitrovicës, po njëkohësisht është edhe anëtare e rrjeteve të ndryshme në Kosovë por edhe në rajon, dëshiroj shkurtimisht të ju them pse unë gjegjësisht organizata ime jemi kyç në këtë proces dhe kur d.m.th në vitin e kaluar kam qenë e ftuar nga Fondi në njërën prej konsultimeve të organizatave për të drejtat e njeriut në Beograd, ku kanë qenë organizata të ndryshme, njëkohësisht ka patur organizata të të rinjve, një numër më i vogël ka qenë i organizatave nga Kosova dhe paraprkisht isha e informuar gati dy vjet më përpara kishin filluar disa prej konsultimeve me grupe të ndryshme të të rinjëve në rajon d.m.th. në Kroaci, në Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi edhe kur u përmend d.m.th. prej grupeve iniciativa për themelimin e një komisioni të tillë rajonal, e kam përkrah fuqimisht dhe mundem me thënë ndoshta si një aktiviste e të drejtave të njeriut, ndoshta e kam një fare doze të fajit që konsideroj që shumë pak është bërë d.m.th. prej organizatave, që shumë pak ka pas bashkëpunim, ndoshta në mënyrë individuale ka pasur organizata, të cilat kanë punuar me një shoqatë apo me një asociacion tjetër mirëpo si platformë besoj që janë munduar dhe ka qenë një boshllëk shumë i madh edhe e kam konsiderua që ndoshta është koha e fundit dhe me të vërtetë jam gëzuar që ka filluar kjo nismë që duhet sa më shumë të bëhet edhe këtu në Kosovë. Nuk po them që askush s'ka bërë asgjë sepse me të vërtetë i kemi disa prej shoqatave këtu, po i përjashtoj disa shoqata d.m.th. shoqatat e edhe d.m.th. juve që jeni prezent këtu se jeni munduar për të punuar mirëpo po flas prej këndvështrimit tim d.m.th. organizatave tjera. Qysh edhe në Beograd në atë takim kam thënë që duhet sa më tepër pikësëpari të informohemi d.m.th. të informohen edhe organizatat tjera si shoqëria civile te na në Kosovë d.m.th. çka është bërë, çka duhet të bëjmë me këtë komision, këto pyetje i kam parashtrua edhe vetë se d.m.th. e kam ditë një objektiv të qartë se duhet të gjendet e vërteta dhe duhet të përcaktohen faktet për krimet e luftës në ish Jugosllavi, mirëpo ideja ime d.m.th. edhe atje edhe e disave tjerë ka qenë që të organizohen sa më shumë konsultime në Kosovë me grupe të ndryshme, pastaj kam marrë pjesë edhe në disa takime tjera ku edhe një prej trajnimeve ku kanë qenë edhe të prezantuara komisione të ndryshme nëpër të gjithë për të cilat d.m.th unë për veti jam, mundem me thënë që ndoshta jam fascinua për rezultatet e arritura sidomos për komisionin Maroko që e përmendi edhe zonja Kandiq, që me të vërtetë nëse bashkohen të gjitha forcat bashkë d.m.th çka mundem me bo, çfarë rezultate pozitive mundem me arrit, në muajin qershor e kemi organizuar një takim kuptohet gjithsesi në bashkëpunim me Fondin për të Drejtën Humanitare edhe organizata ime kemi organizuar një takim në Mitrovicë në qershor të këtij viti ku kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i organizatave të Kosovës, të vendeve të ndryshme por edhe disa prej juve d.m.th që jeni këtu prezent d.m.th. pjesëtarë të asociacioneve të personave d.m.th. të viktimave edhe ka pasur edhe përfaqësues të mediave, unë për veti jam ndi shumë mire kur i kam pa që ka mbretërua një brengë e përbashkët e të gjithave d.m.th. e të gjitha organizatave, mund t'i përmend që pas atij takimi njëzet e pesë organizata, mund t'i numëroj edhe këtu secilën veç e veç, po ndoshta nuk është nevoja, të cilat kanë shpreh gatishmëri që t'i bashkohen kësaj initiative d.m.th. të cilat do ta tregojnë edhe përvojën dhe përkushtimin e vet për këtë çështje edhe në këtë forumin e katërt rajonal që është planifikuar të mbahet në tetor këtu në Kosovë edhe d.m.th. thjeshtë duhet një informim më i madh, më konkret d.m.th. duhet një bashkëpunim më i madh dhe koordinim i punëve, pastaj ka ndodh edhe një takim e një organizate joqeveritare e Prishtinës këtu 'Integra', në muajin e kaluar e ka bërë një hulumtim për ballafaqimin me të kaluarën ku edhe aty ka qenë edhe prezent, ku po i shoh edhe disa fytyra prej kësaj

tavoline që kanë qenë prezent, ku njëri prej rekomandimeve të atij takimi ka qenë edhe d.m.th nisma apo fuqizimi i kësaj iniciative për një komision rajonal kështu që unë mendoj që. po e shoh një progres bukur të madh këtu në Kosovë, një interesim bukur të madh të njerëzve, të organizatave, të platformave të ndryshme sepse këtu hyjnë edhe platforma organizata, jo vetë organizata të cilat punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të paqes, mund të përmend këtu se kemi pasur takim unë dhe zonja Kandiq edhe me Presidentin e Kosovës zotin Sejdiu, të cilit i kemi shpreh, e kemi informuar d.m.th se çka mendojmë të bëhet dhe njëkohësisht i kemi prezentuar vetëm nevojat dhe idetë dhe nevojën e një bashkëpunimi , e njëra prej ideve që ia kemi prezentu edhe presidentit e më pas edhe Zëvendës kryeministrit Hajredin Kuqit, i kemi tregu që ia vlen që të kemi këtë konsultim këtu si dhe disa forma tjera të ndryshme me të gjithë juve edhe mundem me thënë që ka qenë një përkrahje shume e madhe nga ana e institucioneve që më bën ndihem më e fortë në tërë këtë proces, ndoshta. çka kisha pas qef unë të dalin prej kësaj dite, po them me dal me ndonjë konkluzion, rekomandim apo diçka të ketë mirëpo po them që ta shfrytëzojmë këtë hapësirë edhe ta drejtojmë energjinë në bisedime në atë mënyrë se cila është rruga më e mirë, kush duhet të jetë në këtë komision, të gjithë ato brenga, gjithë ato dilema, të gjitha ato pyetje që i kemi t'i parashtrijmë këtu, mendoj që ky është vendi më i duhur sepse mendoj që këtu ka njerëz me një bagazh shumë të madh që kanë punuar, kemi njerëz me brenga dhe shumë pyetje edhe unë për veti edhe unë kam pyetje shumë, kështu që prej këtij takimi po shpresoj të dalim me një energji ku t'i bashkojmë të gjitha forcat së bashku prej të gjitha anëve, së paku forumi i ardhshëm në muajin tetor, në fund të këtij muaji, që me të vërtetë të jetë një vend ku do të jetë një nismë e mbarë për këtë komision, e dimë që është proces i dhimbshëm, e dimë që është proces shumë i ndijshëm, mirëpo e dimë që është më se i nevojshëm, andaj edhe është ky përkushtim edhe ky seriozitet, prandaj unë nuk do të flasë më shumë sepse mendoj se kam marrë bukur shumë kohë dhe mendoj që këtu ta ndërpresë, kështu që faleminderit.

Diskutimi mbi iniciativën rajonale dhe mbi mënyrat tjera të përcaktimit të së vërtetës mbi krimet e luftës nga pikëpamja e viktimave

Bekim Blakaj: Valdete faleminderit shumë e kemi tejkalu pak kohën e paraparë me program, megjithatë tani është koha që ta hapim debatin, ju kisha lut që të fokusohemi në temë d.m.th. në vetë këtë iniciativës rajonale dhe mënyra tjera të përcaktimit të së vërtetës për krimet e luftës. Në fakt unë mendoj që ju jeni njerëzit më të thirrur për ide të reja, sepse nga përvoja ime që e kam në terren unë e di se sa kanë punuar shoqatat e familjarëve në mbledhjen e fakteve në terren dhe mendoj që nga ky debat do të nxjerrim ide të reja për mënyrën e nxjerrjes së fakteve edhe adresimit të tyre d.m.th kisha pas dëshirë që meqenëse e fokusuar në nevojat për përcaktimin zyrtar dhe kumtimin publik të fakteve për krime të luftës edhe nga ju kisha pas dëshirë të dëgjoj më shumë për rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të familjarëve të viktimave dhe të shoqatave të familjarëve të viktimave rreth në procesin e konsultimeve rajonale. Do të ju kisha lut që kushdo që e merr fjalën të prezantohet paraprakisht e mandej të flasë. Debat i hapur, e dëshiron dikush fjalën? Po zotëri Bajram Qerkini

Bajram Qerkini: Kryetar i Këshillit të Familjarëve të pagjetur ku e kam qafën shumë të shkurtë, ku nuk mundem shumë me duru, ku jam njeri ende i papjekur në politikë, ku kërkojmë të pagjeturit dhe përplasemi ende të na plasni barkun më shumë se që na kanë plasë ata përpara dhe që i kërkojmë fëmijët, ju jeni kah folni për një

komision, që ndoshta është ndonjë iniciativë e mirë, ndoshta duhet shumë për tu menduar se për çka formohet komisioni, ne këtu e kemi kryetarin e komisionit të të pagjeturve e ska zyre, kur ne kemi lyp para shtatë- tetë viteve që të formojmë ne një komision në Kosovë, e nuk na kanë lënë njerëzit jashtë Kosovës me marrë frymë e jo me formu komisione, të cilat unë them për Kosovën janë zero. Në Kosovë duhet të punohet diçka tjetër! Më vjen shumë keq, prej Mitrovicës thotë kanë marrë pjesë familjarët kur kanë marrë pjesë vetëm disa të rinj që nuk e kanë kërkend të humbur, më vjen keq kur lëvdohet Mitrovica e nuk përmenden edhe sa janë të pagjetur edhe sa nënave iu kanë marrë fëmijët nga prehri edhe sa nëna janë shkarkuar edhe sa nëna sot janë që para tre dite e ka lajmërua fëmijë gjashtë javësh që ia kanë marrë nga prehri, më vjen shumë keq se iniciativa është e mirë por nuk është në kohën e duhur, ne po kërkojmë të formojmë një institut, lehtë e ka Vesna, lehtë e ka Natasha se i kanë institutet të kompletuara dhe kam pas rast të flas me drejtorin e institutit të Zagrebit kur ai ka dokumentacion shumë të madh dhe hulumton shumë jo vetëm me shoqata por edhe me shtetin e vet dhe prapë nuk është i kënaqur me ato përgjigje të cilat i ka. Çka të bëjmë në Kosovë, çka unë si familjar të flasë, të bëjmë një komision regjional në Jugosllavinë e kaluar kur ende kush nuk më konsideron si njeri, ende nuk i kam dyert qel unë në institucionet tona, kur unë asnjëherë unë nuk e di a është, nuk dua të flas pasi nuk është ai këtu, ka punuar gjashtë vjet te unë, nuk e di ku a ka djalin, njëherë jam takuar me të edhe ka kërkuar falje e asnjë femër, asnjë nënë e asnjë babë e asnjë serb nuk e kam ndi kah e kërkon djalin pos atë, çfarë komisioni regjional po doni me e formu me Serbinë, me qato që nuk të njeh, me atë që nuk të flet, me atë që të hap për çdo ditë luftë? I vogël e i madh po na shpall luftë, ju kisha lut keni kujdes çka po folni, keni kujdes me kënd po folni, ju kisha lut mos na tranoni se boll jemi tranu, ne lypim fëmijë, lypim mënyrë reale që të më bindni mua që t'u them familjarëve ka fol Natasha Kandiçi përnime me i gjet fëmijët, e jo librat e saj, flasin shumë për të kaluarën e aspak për hapin që mjerisht Kosova është dhjetë herë mundet me shku te presidenti e unë nuk mundem me shku njëherë një vit, nuk kemi ne fuqi që të formojmë komisione, sidomos këshillin punues e kisha lut se e kemi pas edhe njëherë këtë diskutim shumë, kemi fol shumë për këtë, jemi ardh me ju tregu se nuk është koha në Kosovë për ta formu qat komision, neve na duhen shumë disa sende tjera motër, neve po na shkojnë murg-morg me varre, faktet e njerëzve që pi gjejmë po shkojnë po hyjnë në dhe s'kemi ku me i lënë, nuk don me na përkrah qeveria, nuk don me na përkrah komuna, nuk don me na përkrah asnjë komision, komisionin e kemi formu me iniciativë e s'don me e përkrah qeveria, tash do ta formojmë një komision regjional me na ndreq punët edhe ai me punu e me marrë krejt bota edhe merret shembull Maroka, unë kam qenë në iftar te gjenerali marokian, kam pas me shku në Maroko për shkak se Serbia nuk e ka njoft pasaportën e UNMIK-ut e s'kam mundur te shkoj, kam biseduar me të, e kam pa çka kanë punuar, por ata kanë institucione tjera, sikur ti Vesna që i ke atje, sikur kjo Natasha që i ka atje, i kanë të tëra e ne nuk kemi kurrgjë, ne e kemi një kryetar të komisionit, i cili s'mundet kurrgjë me bo, e kemi pas përpara, i kemi pas dy, tre kurrgjë s'kanë mundur të bëjnë, ju kisha lut për këtë ne s'kemi çka të bisedojmë, është i mirë, kemi qef me pas komision të tillë pa neve, se ne kemi disa punë tjera me i kry, kur ti kryejmë këto punë tjera në qeveri edhe në shtet po mandej kemi me i qu gishtat edhe kemi me i përkrah tamam qysh duhet, nëse mundeni me na ndihmu me pas një zyre e me i mbajt mbledhjet e jo me i mbajt ato në sokak, nëse mundeni me na ndihmu me e qel një shtëpi të vogël ku mundemi me i qit qato sende d.m.th. qe ky është djali i Bajram Qerkinut që është hup me këtë datë këtë datë ose që ky është i masakruar ose qe kjo nënë është e gjallë, të cilën e kanë shti me pi çorbën e djalit gjashtë vjeç, ju kisha lut, të kemi çka të

punojnë të formojnë një tjetër institucion e komisionin po e lejojmë atij nivelit që jeni tuj fol.

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Qerkini! Në fakt unë pajtohem me juve në atë pikën që e përmendët që shoqatat familjare të viktimave nuk janë të përkrahura, nuk janë të përkrahura as nga institucionet lokale as qendrore këtu në Kosovë, mirëpo unë mendoj që përmes këtij komisioni kishte mundur të bëhet një lloj presioni institucioneve se më në fund të fundit edhe është obligim i tyre që të sigurojnë mënyra të ndryshme të sigurojnë punë më të suksesshme, gjithsesi komisioni si mision kryesor, e morët e përmendët edhe ju komisionin e Marokut, a ka për të gjetur ende persona që figurojnë si të zhdukur d.m.th. unë besoj se ky mision përputhet edhe me misionin e shoqatave të juaja, zonja Natasha Kandiç e kërkoi fjalën, dëshiroj që të ia jap asaj fjalën, urdhëro.

Natasha Kandiç: Unë vetëm dua të përgjigjem në disa koknstatime të zotëriut Qerkini. Mua nuk më pëlqen kur ai thot “ kjo nuk është koha për Kosovën “. Kosova nuk mund të pret dhe nuk duhet të pret. Secila pritje paraqet largim dhe izolim nga ky rajon, nga Ballkani. Dhe po vërehet se Kosova nuk po merr pjesë në shumë iniciativa rajonale të cilat janë të rëndësishme. Kosova ka të kaluar të përbashkët, njerëzit kanë jetuar në shtetin e njëjtë. Izolime të shumta të njerëzve kanë ndodhur këtu, në një shtet i cili është quajtur Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë. Shumë njerëz këtu, sigurisht ka të tillë, që e dinë, se sa njerëz kanë qenë të izoluar në ato vitet e tetëdhjeta. Kjo është një e kaluar e përbashkët, për këtë duhet të dihet. Këtu kanë ndodhur krime lufte për të cilat duhet të flitet në nivelin rajonal, nuk duhet ta ndal Kosovën gjithnjë ajo se kinse nuk është koha. Ne të gjithë e dimë se politika serbe është e gabuar në lidhje me Kosovën. Kjo që nuk është duke e pranuar Kosovën nuk është mirë, askujt nuk do t’ia sjellë të mirën. Po ju lutem, ta lëmë atë farë niveli politik. Tani kemi diçka që është shumë më e rëndësishme se çdo territor, se çdo çështje politike, kjo është çështje e jetës dhe vdekjes. Sa shumë njerëz janë vvarë në mënyrën më të tmerrshme. Ajo çka ka ndodhur në Kosovë nuk mund të krahasohet as me krimet në Bosnje, as në Kroaci sepse këtu institucionet e Serbisë kanë vepruar në mënyrën në të cilën nuk veprohet në asnjë luftë. Ne këtu kemi patur djegjen e njerëzve përbrenda shtëpive, përndjekjen e njerëzve në mënyrën më të tmerrshme... Ju të gjithë e dini se si kanë përfunduar 68 njerëz në Mitrovicë, çka ka ndodhur në Mejë, çka ka ndodhur në Korenicë. Me rëndësi është që këtë të gjithë ta dijnë. Nuk kemi kohë të presim. As Kosova nuk e ka këtë kohë për të pritur dhe nuk duhet të pres. Duhet të shkojë me hapat e njëjtë si Kroacia, si Bosnja. Në Serbi ekziston shoqëria civile, e fuqishme, e cila e kërkon të vërtetën, faktet se çka ka ndodhur në Kosovë. Duam të dimë se çka ka ndodhur në xhami në Qirez. Është me rëndësi që këtë ta dinë të gjithë. A po merret kush me këtë tani? Jo. Janë marrë në vitin 1999, e sot askush më këtë nuk po e përmend. E din Xhaferi, biri i të cilit është i zhdukur qysh prej atëherë, sepse edhe ai ka qenë në atë xhami. Po të pyesnim tash këta njerëz se a e dinë çka ka ndodhur në Qirez, se çka ka ndodhur në xhami, pastaj çka ka ndodhur në Gillogovc, çka ka ndodhur në Shaverinë. Frikohem se nuk jam e sigurt se sa njerëz mund ta kishin ditur. Ajo vërtetë është e rëndësishme për ne, lëreni tash... Mund të udhëtoni me pasaportën e UNMIK-ut, do të udhëtoni me pasaportën tuaj kosovare por ju lutem mos ta krahasojmë pasaportën me vdekje, me jetë. Ne kemi obligim edhe ndaj disa gjeneratave të ardhme edhe ndaj nipave tuaj dhe fëmijëve të tyre, që tu lëjmë diçka që janë faktet. Por, ju po mendoni se në disa vende të tjera, shoqatat janë në pozitë më të mirë? Sipas mendimit tim, vetëm, shoqatat e familjeve të viktimave në Kroaci janë të mbështetura shumë nga ana e shtetit, por jo viktimat civile, vetëm viktimat ushtarake. Në Serbi këto shoqata janë pak a shumë... ndonjëherë i përkrahin, i përmendin, por ato

nuk luajnë ndonjë rol të rëndësishëm. Tani keni parë, keni mundur të ndjekni, se çka po ndodh në Bosnje me shoqatat, ka edhe individë të tillë të cilët kanë rrënuar imazhin, pasqyrën e shoqatave, sikur që është Shoqata *Pokret Majki Enklava Srebrenice i Žepe (Lëvizja e Nënave nga Enklava e Srebrenicës dhe Zhepës)*, po unë nuk do të ndalem në këtë. Do të doja sikur të bisedonim edhe për këtë, në njëfarë mënyre, duke u nisur nga mendimi se ne të gjithë i kemi borxh, jo vetëm familjarëve të viktimave... Është detyrë e jona, ne të gjithë duhet të ndihmojmë që të sigurohet ai kujtim për atë çka ka ndodhur, të sigurojmë faktet dhe pastaj të bëjmë presion që t'u gjykohet disa kryerësve por për këtë duhet të kemi një qëndrim pozitiv. Duam që të tregojmë se të gjitha ato viktima janë të rëndësishme; duam që të tregojmë çfarë ka ndodhur; duam që viktimat të mund të flasin publikisht, që këto të transmetohen në televizion, që zëri i nënave të mund të dëgjohet, që të mund të tregojnë se çka ka ndodhur në Vushtrri, si kanë përfunduar në shtëpinë e Xhezair Pasomës, si kanë përfunduar aty?

Bekim Blakaj: Më falni zotëri Qerkini, a keni ju ndonjë ide se në çfarë mënyre...

Bajram Qerkini: Unë e kam idenë se në Kosovë duhet të formohet institucioni qysh i ka Natasha dhe qysh i ka Vesna, qatëhere flasin për komision, këtu hiq s'kemi boll më teori, unë i kam të gjeneratës i ke pa në zyre tri gjenerata që nuk e di ku i kam, mosni bre vëllezër njëqind e njëzet e pesë vjet gjyshja Zade prej Likovci ka jetu e nuk e ka ditë ku e ka burrin dhe ku e ka djalin, mirëpo mos t'i përmendin këto sende, të cilat dihen çka tash Natasha na propozon, komisioni po i ndreqka punët?! Komisioni po e shtyjka qeverinë me më ndihmu?! Hajde po e formojmë edhe atë komision, mosni bre për riza të zotit mosni, mosni se ne jemi çmend, 50 % familja janë çmend edhe pesë vetë po doni me i çmend me këto politika, mosni ju kisha lut edhe unë në qofsha i tepërt qohna e shkoj.

Bekim Blakaj: Jo kurrsesi nuk jeni i tepërt, faleminderit për fjalën e juaj. Zotëri Arsim Gërxhaliu po e kërkon fjalën.

Arsim Gërxhaliu: Desha vetëm të ndërhyj pasi një kohë të gjatë e njoh mirë bacin Bajram, është një njeri i pastër, një njeri i cili e thotë troç çështjen, kjo është shprehje e mllefrit, sepse atij i kanë tejkalu të gjitha masat, në vetë faktin tha se vetevetiu që e kam qafën e shkurt duhet ta kuptoni bacin Bajram, me krejt masën të cilën e ka baci Bajram ka të drejtë, nuk ishte kjo një hudhje e fajit ndaj juve personalisht, ju jeni një tejkallim i kohës për neve në Kosovë, të mbaroj me, ta koncentroj pyetjen për aktivitetin në Kosovë, këtu është qëllimi ne asgjë s'kemi bë këndejadi d.m.th. në këtë aspekt për me shku në një hap, të cilin e ka bë Kroacia, Bosnja e Hercegovina, Serbia e kështu me radhë, duke u nis prej vetë faktit se e dëgjova nga zonjusha Valdete se ju keni kërkuar së bashku me zonjën Natasha dhe me presidentin e Kosovës, komisioni ynë qeveritar takohet vetëm atëherë kur kemi me u taku me palën serbe dhe asnjë aktivitet tjetër komisioni nuk ka, duke u nisë prej faktit që e tha edhe zoti Qerkin se as zyre nuk ka kryetari dhe aktivitet tjera janë zero negativ dhe jo pozitiv, po zero negativ, e mos të flasim për aktivitetet e centralizimit të dokumentacioneve, komisioni qeveritar nuk as centralizim të dokumentacioneve, thesarin e dokumentacioneve e kanë shoqatat e familjarëve, një thesar të cilin kurrë asnjëra qeveri në Kosovë nuk ka arrit me e mbledh atë, me e centralizu dhe nuk kanë faj që e kanë humb besimin, mos ta merr këtë qeveria e fundit apo e parafundit por e kanë humbur besimin në secilën qeveri. Mua më kujtohet mirë kur kam kërkuar në 2004-tën prej kryeministrit Rexhepi që shoqatave t'i ipet së paku nga një makinë fotokopjuese e nga një kompjuter, ata nuk janë në gjendje krejt atë material me ia fotokopju në qeveri edhe me e bo një centralizim e ajo nuk ka ndodh ende do të thotë po hyjmë në vitin e dhjetë, kështu që mos e merrni afër zemrës reagimin e axhës Bajram sepse ai filloi shumë mirë, ai filloi

prej bazës, ai e tha shumë thjeshtë, e kam qafën e shkurtë, njeriu ka dhimbje në vete, njeriu ka dhimbjen për të cilën kur s'ka pas përgjigje, edhe unë kam pësuar në familjen time, në fshatin Studime atje, por ai ka dhimbje mu në dorën e parë do të thotë, unë tash si Arsim Gërxhaliu iu kisha drejtuar bacës Bajram me vetë fjalët e tij që i tha deri tash, e kjo përmbledhet në këtë formë që krejt çka tha baca Bajram dhe krijimi i këtij komisioni ndoshta do të ishte baca Bajram një tejkalim apo një plotësim i punës së mangët të qeverive dhe një presion direkt në kokën e tyre, unë pasi që dëgjova që në fundin e muajit tetor do të krijohet një gjë e tillë në Prishtinë dhe duke e marrë parasysh se prej Kroacisë, Bosnjës, Serbisë është zgjedhur Prishtina si vend në të cilin do të krijohet një çështje dhe do të jetë si vend i krijimit që do të jetë edhe një formë historike, me këtë deshëm apo s'deshëm zonja Natasha e tha se politikisht nuk mundemi t'i ikim edhe pse kemi luajtur na letrën e humanitarizmit, krejt ka qenë politikë, d.m.th. politikisht nuk mundemi t'i ikim. Me këtë tregohet edhe do të thotë se Kosova e pavarur është një qendër e stabilizimit d.m.th. të rajonit dhe pikërisht është kompliment për Kosovën që mysafirët prej Kroacisë, Bosnjës, Serbisë të jenë pjesëmarrës këtu dhe të njëjtën ta krijojnë në Kosovë. Faleminderit.

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Gërxhaliu, vetëm desha të ju sqaroj një çështje në forumin e IV-të rajonal me 28 dhe 29 tetor do të formalizohet koalicioni, ju faleminderit shume, dikush tjetër e don fjalën, po urdhëroni prezentohuni ju lutem!

Artan Selimi: Unë jam Artan Selimi përfaqësoj organizatën 'Loti dhe kujtimi' nga Podujeva, desha ta marr fjalën e përkrahi fjalimin e Bacit Bajram dhe të Arsimit që e pat, këtu e kam një material që më ka rënë në dorë për themelimin e komisionit rajonal, ku është qëllimi i këtij komisioni me u formu a me përkrah gjykata e Serbisë që janë dal fund.

Natasha Kandiç: Zotëri Selimi, nuk është mirë kjo që po flisni kështu. Nuk e di se çka do t'iu thoshte Enver Duriqi dhe çka do t'iu thoshte Selatin Bogujevci. Po flisni me njëfarë toni negativ, e keni njëfarë zemërimi në vete dhe nuk është mënyrë e mirë, as për ju e as për disa njerëz të tjerë, si Enveri e Selatini, të cilët nuk janë këtu. Askush këtu nuk po e përfaqëson as gjyqin serb, as atë kosovar, as gjyqin boshnjak-hercegovas. Ne të gjithë e përfaqësojmë të dënuarit e atyre të cilët kanë kryer krime të luftës, para cilit do gjyq që ai gjykim mbahet, për derisa ai gjykim i përmbahet standardeve të gjyqimit profesional dhe objektiv. Pra, sidoqoftë, edhe po të bëhet fjalë për gjykatat e Kosovës apo ato të Beogradit, nëse gjykohet dhe nuk ka asnjë vërejtje e cila mund të thotë se gjykimi nuk ka qenë i drejtë, që nuk ka qenë fer, që kryerësit nuk janë dënuar sipas veprës penale që e kanë kryer. Për krimin në Podujevë është mbajtur një gjykim, njëri ka qenë i dënuar me dënimin maksimal të cilin e parasheh ligji, është dënuar me 20 vite. Tash po gjykohen katër të akuzuar të rinjë për të njëjtën vepër. Pra, sipas kësaj shihet se ne po e përkrahim dënimin e atyre që janë kryerës të krimeve të luftës. Dhe, kjo është edhe baza e kësaj iniciative, por edhe po themi se ne nuk besojmë që ka gjykata të cilat kanë kapacitete të mjaftueshme që t'i gjykojnë të gjithë ata të cilët i kanë kryer krimet e luftës. Dhe ju lutem që ti përmbaheni fakteve e jo të flisni thuase jeni në ndonjë tubim partiak dhe flisni atë që iu është caktuar ta thuani.

Vesna Tershelliç: Vetëm një fjalë. Në këtë iniciativë, ne përkrahim gjykimet e drejta para Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish- Jugosllavinë në Hagë, para gjykatave të Serbisë, Bosnjës e Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Kosovës. Pra, gjykimet e drejta kërkojnë përkrahje dhe kjo iniciativë sigurisht se iu ofron përkrahje plotësisht.

Bekim Blakaj: Tani e ka fjalën Teki Bokshi, Haki Kasumi e ka kërku e mandej zotëri Prenk Gjetaj nga komisioni qeveritar për persona të zhdukur, urdhëroni zotëri Bokshi

Teki Bokshi: Bekim unë mendoj para së gjithash janë te arsyeshme edhe reagimet emocionale të personave të cilët kanë pas viktima gjatë luftës, meqenëse në Kosovë është krejtësisht e vërtetë se këta janë absolutisht janë të injoruar dhe se praktikisht institucionet shtetërore, të cilat është pritur që këta të kenë së paku një mbështetje logjistike për punën e tyre që të jetë e fuqishme se sa kjo që ka ndodh deri tash, megjithatë unë mendoj që kjo iniciativë për formimin e komisioneve në radhë të parë vendore, në radhë të parë nacionale e pastaj edhe rajonale. Në Kosovë zhvillimet e gjatë luftës kanë qenë në rrethana krejtësisht specifike përderisa në luftën në Kroaci edhe në Bosnje e Hercegovinë i kanë pas shtetet e tyre, institucionet shtetërore ushtarake e policore krejtësisht të organizuara, qeveritë në të cilat i kanë përcjellë spitalet, i kanë përcjellë viktimat, në rrethanat e luftës në Kosovë ne kemi pasur vetëm formacionin tonë të armatosur UCK, që ka qenë formacion ushtarak dhe në formim e sipër me një numër relativisht të vogël të njerëzve, ndërsa në anën tjetër kemi pas një makineri absolutisht agresive antishqiptare e antikosovare, e cila ka bërë çdo gjë që të zgjidh njëherë e mirë çështjen shqiptare në Kosovë apo siç e kanë quajtur ata çështjen serbe në Kosovë dhe se krimet, përpjekjet tjera më të mëdha janë bërë për fshehjen e krimeve dhe fshehjen e viktimave kështu që për ne mendoj se është shumë aktual që të bëhet përpjekje maksimale për identifikimin e viktimave, identifikimin e kryesve të veprave kriminale dhe gjenocidit që ka ndodh në Kosovë. Duhet ta kemi parasysh se tani për tani në Kosovë krejt këto të dhëna lidhur me ndodhitë që kanë ndodh gjatë luftës dhe ndodhitë që kanë ndodh janë të fragmentarizuara, ta zëmë në Gjakovë ku ka qenë një ndër qytetet që ka qenë i viktimizuar ekzistojnë dy organizata për, që i mbrojnë interesat e familjarëve të viktimave siç e dini ju është organizata OJQ-ja “Thirrjet e nënave” dhe “27 prilli”. Në Kosovë manipulohet me disa të dhëna që praktikisht janë të dhëna të NATO-s se në Kosovë janë vra 13.000 njerëz, se në Kosovë janë shpërngul 800.000 njerëz se janë djegë ose devastu 127.000 objekte ekonomike dhe individuale, por ne sot në Kosovë nuk e kemi një institucion, i cili mundet që të na jep të dhënat që të ketë në data baza të tij se ku dhe kur kanë ndodh ato krime, kush i ka krye ato krime dhe në çfarë periudha kohore, ne kemi një mori për shembull të incidenteve kriminale që kanë ndodh duke filluar prej Qirezit, Likoshanit, Recakut, Gjakovës, Mejës, Mitrovicës, Fushë Kosovës e tjera një mori incidentesh shumë serioze për të cilat ishte dashtë ne si për shembull ne së paku në qoftë se nuk i besojmë institucioneve legjislative të Serbisë t’i ofrojmë institucioneve të Hagës. Por ne nuk kemi qenë në gjendje që në mënyrë të centralizuar dhe të sintetizuar që t’i ofrojmë informacione çfarëdo institucioni për ato ndodhi dhe të krijojmë kujtesë historike tonën për ndodhitë në Kosovë. Prandaj e konsideroj se formimi i këtij komisioni sipas pikëpamjes sime, unë e përkrahi këtë pikëpamje që të formohet një komision të realizuar, meqenëse një pjesë e vogël e krimeve edhe viktimave që janë zbuluar në Kosovë praktikisht janë zbuluar me kontributin e shoqërisë, kryesisht e kontributin e shoqërisë civile në Kosovë dhe kryesisht për aq sa kam unë informacione, meqenëse një kohë kanë punu edhe të Fondit për të drejtën humanitare që këto viktima të cilat janë sjell në Kosovë janë kontribut jo i dashamirësisë së qarqeve qeveritare të Serbisë, por pikërisht për shkak të angazhimit institucional të shoqërisë civile në Serbi. Përfundimisht kjo dilema, kjo që u ngrit lidhur me gjykimin, edhe pse nuk është objekt i shqyrtimit, është e vërtetë që ka dilema në Kosovë se a është mirë që procesohen kriminelët serb, të cilët kanë bërë krime në Kosovë të procesohen në Serbi, standardi elementar i ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare

është që krimet e luftës në qoftë se nuk procesohen nga institucionet ndërkombëtare atje, duhet të procesohen në vendin ku janë kryer krimet, mirëpo unë e konsideroj që është më e dobishme ta zëmë rasti i këtij krimineli Sasha Cvjetan, i cili është gjykuar me dënim maksimal për dhembjet dhe për krimet që i ka bë në Podujevë, që të gjykohet në Beograd për shkak se në rrethanat aktuale Ballkanike absolutisht është e pamundshme që ky të sillet dhe të gjykohet në Kosovë. Kur ajo mundësi nuk ekziston, objektivisht, asolutisht është e pamundur që Kosova ta kërkon nga Serbia ekstradimin e një shtetasi edhe pse dihet se ekstradimi i shtetasit të vet nuk lejohet po që të sjellet në Kosovë që të gjykohet, po absolutisht s'është e mundshme që ai të gjykohet në Kosovë, atëherë mendoj që është më e dobishme në Serbi, më humane që së paku familjarëve të atyre viktimave t'u ofrohet një satisfaksion moral në kuptimin që e kanë ekspozu në Beograd. Unë kam marrë pjesë në mbrojtjen e familjes së dëmtuar në gjykimin e Sasha Cvjetanit, ai gjykim ka qenë një tronditje, një nxitje e opinionit, së paku e opinionit të ndershëm në Serbi, kur baba i tij Enver Duriqi në pultin e dëshmimit në gjykatë për krime të luftës në Beograd i ka prezentu se nga familja e tij e tërë familja prej katër anëtarësh, prej katër fëmijësh nënës e babës i kanë mbetë disa porta të fëmijëve si kujtesë e asaj çka i ka ndodh, unë kam asistuar në atë shyrtime edhe ai praktikisht e ka nxit tërë opinionin dhe mediat pandërprerë kanë shkruar se çka ka ndodh në Kosovë. Meqenëse një pjesë e madhe e opinionit në Serbi nuk e din se çka ka ndodh në Kosovë, nuk është i informuar për shkak se institucionet e atëhershme bile edhe të tashme janë të interesuar që të mbajnë embargo në informacionet për krimet monstruoze që kanë ndodh në Kosovë, duhet ta kemi parasysh se kemi pasur situatë krejtësisht specifike. Për 78 ditë në Kosovë kanë ndodh krime monstruoze edhe intensiteti i dendësisë së krimeve ka qenë aq i madh sa nuk mund të krahasohet as me situatën në Kroaci as me situatën në Bosnjë e Hercegovinë, është e vërtetë që lufta në Bosnjë e Hercegovinë ka zgjatur tre vjet e gjysmë, mirëpo në Kosovë për 78 ditë kanë ndodh që dendësia e krimeve ka qenë aq intensive dhe askush s'ka mundur t'i përcjell, kështu që ne e kemi shumë vështirë që të plasojmë informacione po që se nuk i centralizojmë të dhënat, unë plotësisht pajtohem dhe kam informacione dhe gjithaq të hollësishme se edhe në Kroaci e Bosnje e Hercegovinë ka institucion shtetërore të cilat i kanë sintetizuar të dhënat edhe ta zëmë se kanë për secilin incident informacione. Unë po e kuptoj se formimi i këtij komisioni në nivel njëherë së paku të Kosovës e mandej në bashkëpunim rajonal është edhe pikësynim që këto të dhëna dhe këto informacione lidhur me krimet në Kosovë që kanë ndodh të decentralizohen dhe që me to po merren njerëz që janë ekspertë në këtë lëmi edhe jo vetëm njerëz që kanë dhembje që kanë dashamirësi që të zbulohen krimet se kjo është megjithatë punë shumë profesionale, unë po e kuptoj se në këtë komision do të duhet që të asistojnë policë me përvojë të madhe, prokurorë me përvojë të madhe, avokatë dhe juristë tjerë që merren me çështje penale, të cilët duhet të organizojnë identifikimin e krimeve, sintetizimin e të dhënave edhe që nesër apo pasnesër së paku në qoftë se munden të procedohen. Në asnjë konflikt në asnjë luftë s'ka ndodh që të procesohen të gjithë kriminelët e luftës, së paku të kemi një kujtesë historike që të dimë çka ka ndodh në Kosovë, meqenëse fatkeqësisht deri tash çdo gjë është e fragmentarizuar dhe një pjesë e madhe është ende e pazbuluar, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Bokshi, tani ia japi fjalën zotëri Kasumi, Kryetar i Këshillit Koordinues i Shoqatave të Familjarëve, urdhëroni zotëri Kasumi.

Haki Kasumi: Faleminderit që më prezentoj kryesuesi i kësaj konsulte, unë jam Haki Kosumi, momentalisht ose me këtë rast përfaqësoj Këshillin Koordinues të Asociacioneve Familjare të Kosovës por njëkohësisht përfaqësoj edhe shoqatën time për hulumtimin e fatit të personave të pagjetur në nivel të Kosovës, i lus të pranishmit

dhe sidomos përfaqësuesit e Këshillit Koordinues që para së gjithash të bëjnë përpjekje ta kuptojnë drejtë qëllimin e kësaj konsulte, kjo është një konsultë me fjalë tjera një takim, një tubim ku shqyrtojmë çështje të cilat me rëndësi të jashtëzakonshme, me rëndësi të madhe edhe për misionin e Këshillit gjegjësisht të shoqatave që në fakt brum e kanë hallin, problemin e familjarëve të goditur nga lufta e fundit në Kosovë. Gjendja në Kosovë çfarë është konsideroj se e dimë të gjithë në një formë por specifikat dhe dallimet në mes të gjendjes dhe të kalurës së Kosovës dhe të viseve tjera të ish Jugosllavisë ekzistojnë dhe mu nga panelistët dhe në mënyrë të veçantë nga fjala hyrëse e zonjës Natasha Kandiq më vjen mirë dhe më erdh mirë shumë që megjithatë është serbe e dalluar, sepse dallon në qasje të saj nga qasja zyrtare e shtetit serb dhe do të thoja nga qasja e përgjithshme, që ne si palë e goditur, si viktimë e kësaj lufte të fundit marrim mesazhe të tilla të cilat i përcolli Bajram Qerkini, marrim kërcënime dhe marrim gjithashtu edhe kërkesa për hapje të fronteve të reja të krijimit të viktimave të reja dhe të zhdukjes së njerëzve dhe më tepër se sa që janë zhdukur deri më tash, me fjalë të tjera unë do të bëja përpjekje dhe do ta lutja bacin Bajram dhe të tjerët që komisioni për të cilin po debatohet në këtë konsultë është diçka tjetër me këshillin regjional me të cilin zhvillojmë një betejë të them ashtu tash e sa vite dhe ku nuk kishte principe, nuk kishte rregulla të përfaqësimit të barabartë në atë Këshill Regjional gjë për të cilën ne e kemi refuzuar bashkëpunimin deri tash. Atje vazhdohej me një politikë ndaj të cilës ne shqiptarët jemi shumë të ndejshëm me politikën e diskriminimit në përfaqësim, ku kërkohej që shtetet gjegjësisht viset tjera, gjegjësisht republikat tjera të ish krijesës artificiale të quajtur Jugosllavi të përfaqësohen në një mënyrë tjetër në një mënyrë shumë me ma tepër përfaqësues, ndërsa Kosova të përfaqësohet gjegjësisht të trajtohet ashtu si është trajtuar në mënyrë jo të drejtë si provincë, gjegjësisht krahinë ose pjesë e pjesëve të asaj krijese artificiale. Komisionin e propozuar unë e kam menduar një kohë të gjatë dhe e kam analizuar në kokën time, fatkeqësisht nuk kam mundësi me përfaqësuesit e institucioneve tona, me përfaqësuesit e qeverisë tonë që ta shqyrtoj dhe analizoj deri sa të vijmë në një përfundim të drejtë se sa është interes i Kosovës në përgjithësi si shtet në krijim dhe në mënyrë të veçantë se sa është interes rast real i asociacioneve dhe në mënyrë të veçantë i familjarëve të goditur të Kosovës, unë personalisht shfaq mendimin tim se çdo iniciativë që ka për nisëm, që ka për bazë humanizmin, që ka për bazë nxjerrjen në dritë të një realiteti dhe ndriçimin e gjithë asaj që ka ndodh në Kosovë është në interes të përpjekjeve tona, të punës tonë, të këshillit tonë, të shoqatave tona dhe në mënyrë të veçantë ka dobi dhe interes edhe familjari, ju lutem te ne në Kosovë dhe mendoj përgjithësisht te ne në Ballkan dominon një bindje se ajo çka na ka ndodh me ne, ose ajo çka më ka ndodh mua, ose dhimbjen time nëse kam arrit të ia tregoj dikujt se krejt bota e din, ju lutem bota dhe njerëzit e botës dhe të regjionit janë aq të goditur aq të bombardua me informata edhe të pavërteta sa që minutat janë në pyetje sa bota ose njerëzit rreth nesh janë të informuar realisht me të vërtetën ose me atë që ne mbajmë në shpirt për dhimbjen ose për atë që njerëzit tonë të cilët na mungojnë. Unë konsideroj se për fat të mirë kësaj radhe e kemi edhe përfaqësuesin e qeverisë tonë që është në komision që fatkeqësisht e kemi quajtur dhe qëndron prapa saj edhe sot e kësaj dite se është një komision me emër të mrekullueshëm por që është krejt formal dhe mundësitë edhe qasja por edhe puna e deritashme, derisotme është aq e vogël aq minore sa që për ne aktivistët për familjarët është e padukshme dhe në njëfarë mënyre në vend që ai komision të jetë dritare ose derë e shërimit të dhimbjes ai është më tepër të them ashtu një pikë e cila na shkakton neveri më tepër se sa ndihmë ose përkrahje, që këtë konsultë gjegjësisht këtë iniciativë, të cilën unë thashë në parim mendoj se është interes i joni që ta përkrahim

dhe është një prej formave gjegjësisht mjeteve, me të cilën nëse dimë me e shfrytëzu si duhet ne do të bëhemi presion te qeveria jonë, te institucionet tona që ta shpejtojmë përpjekjen për krijim të mekanizmave të cilët do të krijojnë bazën e të dhënave gjegjësisht do të qitnin në dritë ose do të mundësonin që bota përkrasë e humanizmit, përkrasë e të drejtës të ketë vërtetë pamje ashtu si duhet reale për atë se çka i ka ndodh qytetarit të Kosovës dhe të ketë një qasje më të drejtë rreth ndjekjes gjegjësisht rreth hulumtimit të kryesve të krimit dhe gjykimit të tyre. Kjo është gjë që nuk është kompetencë të shoqërisë civile, por është në kompetencë në mundësi të institucioneve të drejtësisë, të cilat fatkeqësisht unë konsideroj se me plotë të drejtë kryeministri i Kosovës ka thënë por ai përpos fjalës nuk bëri asgjë tjetër po më duket deri më sot, përpos që dha një konstatim shumë të drejtë se ata të cilët janë të thirrur prokurorët po flenë mbi dosjet e krimit, ju lutem ndoshta ky është interes i dikujt por është goditje e ose vazhdim, krim ndaj familjarëve dhe atyre të cilët e kanë përjetuar krimin, me fjalë të tjera po e mbyll këtë fjalë time të rastit me kërkesën përsëri që të bëhen përpjekje që të kuptojmë realitetin dhe qëllimin esencial të kësaj konsulte dhe të jemi racional në përkrahjen ose vlerësimin ose gjykimin e kësaj iniciative eventualisht në përkrahjen nëse e konsiderojmë me të drejtë si njerëz të interesuar për zbulim të vërtetës dhe për një mirëqenie më të mirë të njerëzve të këtij nënqielli të botës, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë zotëri Kasumi në këtë fjalim shumë të qartë, jemi në mesditë dhe ka ardhur koha për pauzë por megjithatë pasi që ka kërkuar fjalën zotëri Prenk Gjetaj, a më falni kam gabuar, sidoqoftë, jo pauzën e kemi po nga ora 12 por megjithatë do të ju dëgjojmë juve e mandej do të shkojmë në kafe.

Prenk Gjetaj: Ju përshëndes të gjithëve në veçanti panelistët, një takim dhe konsultim i tillë sigurisht se do të jep rezultate dhe të ndihmoj procesin e zbardhjes së fatit të të pagjeturve për çka edhe unë jam i angazhuar dhe jam kompetentë, po unë jam kryetar i komisionit qeveritar për persona të zhdukur Prenk Gjetaj. Shfrytëzoj rastin të ju përshëndes për këtë iniciativë për formimin e komisionit, një trupi regjional i cili do të ndihmoj në procesin e gjithëmbarshtëm jo vetëm të zbardhjes së fatit të të pagjeturve gjegjësisht të të zhdukurve por edhe në prezantimin e të vërtetës dhe plasimin e së vërtetës sensibilizimin e opinionit për këtë çështje që unë plotësisht pajtohem me zotin Bajram Qerkini që nuk është vetëm përfaqësues i një shoqate por është edhe përfaqësues, si viktimë edhe këtu kemi plot njerëz të tillë, të cilët vërtetë kanë arsye me qenë shumë të padurueshëm sepse kaluan vite të tëra dhe ankthi ta dini është i njohur se është edhe më i rëndë se vetë vdekja. Nganjëherë dimë, po mendoj vdekja është vdekje që s'mund ta ndryshosh por ankthi, pritja ky nuk përfaqëson vetëm vetveten por përfaqëson edhe familjet prandaj vazhdimisht është nën sulmin, jo vetëm ai por të gjithë ata që i përfaqësojnë shoqatat për persona të zhdukur kanë një përgjegjësi dhe një ngarkesë shumëfishtë për arsye se gjithmonë janë artikulues të kërkesave, të propozimeve dhe të nevojave të asaj dhembjeje që e kanë familjarët, prandaj duhet t'i kuptojmë plotësisht dhe normalisht as si institucion as si individ as si shoqatë nuk mund të themi dhe e kam thënë jo njëherë por shpeshherë dhe gjithmonë dhe do ta them, s'mund të themi kemi bërë mjaft deri sa kemi ende persona që nuk dimë për ta dhe numri i personave të zhdukur nuk është i vogël. Nuk po përdor numra sepse për të gjithë janë të njohur por kërkimet, përpjekjet, angazhimet duhen me qenë vazhdimisht deri në zbardhjen e fatit të të gjithë atyre, të cilët ne vetë me termin të zhdukur nganjëherë prejudikojmë se nuk ekzistojnë më, prandaj me shumë arsye me shumë sens është përmend të pagjetur sepse për shumë persona për të cilët nuk kemi ditur më vonë janë gjetur, prandaj të zhdukur nuk mund të prejudikojmë ose prejudikojmë atë çka e tha zonja Natasha në furnalta, në Maçkaticë apo në Obiliq apo

diku tjetër. Kështu që po them kjo nismë, unë nuk e konsideroj si ndonjë paralelizëm por e konsideroj si një kontribut, edhe individi edhe shoqata edhe një asociacion çfarëdo natyre qoftë që ndihmon dhe kontribuon së paku edhe në numrin sa më të vogël të zbardhjes së fatit të të pagjeturve sigurisht se do ta përshëndesim dhe do ta ndihmojmë, unë plotësisht pajtohem me atë se në opinionin jo vetëm kosovar por në përgjithësi, përgjegjësia është një lloj satisfaksioni dhe përgjegjësinë e kemi shumë të kuartë dhe të lehtë për arsye se kemi mjaft të dhëna, dokumente, artifakte për krimet e bëra në shumë vende sepse ka ekzistuar hierarkia dhe struktura të organizuara me komandë që përveç misioneve që kanë pas për të bërë krime, në anën tjetër kanë pas misione dhe detyra të posaçme për të zhdukur gjurmët e krimeve. Prandaj e kemi të vështirë por mbase do të ndodh ndonjë dëshmitarë kurdo sado dhe pa organizim, pa bashkëpunim nuk mund ta zbulojmë atë dëshmitarë, prandaj është shumë e rëndësishme që u përmend çështja e Maqkaticës, prandaj ka dhe dyshimet ekzistojnë, prandaj a mund të sigurojmë dëshmitarë në Maqkaticë do të ketë ende varreza apo edhe atje ku ka punuar doktori edhe në Batajnicë, që ato varreza nuk kanë qenë në një vend por që mendoj dhe dyshimet vazhdojnë të jenë që do të ketë edhe më tutje edhe varreza të tjera, ku mund të ketë trupa të groposur. Ata na mungojnë ne duhet t'i bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i shfrytëzojmë të gjitha mekanizmat, nivelet lokale, regjionale, normalisht Kosova do ta kërkoj partneritetin e barabartë në këtë aspekt sepse do të ketë efekte pozitive, satisfaksion do të ishte dhe plotësisht pajtohem me atë që e thotë avokati i njohur që gjykimet e kanë efektin human, njerëzor dhe të bëhen aty ku kanë ndodh krimet, sigurisht se do të kishte jehonë sepse tash familjarët atë satisfaksion do ta kishin. Mandej kemi edhe shumë pyetje dhe përgjigje tjera, sepse shumë familje edhe këtu ndoshta kemi familje që manipulohen apo mbajnë, kanë informata që ende mbahen njerëzit e gjallë diku sepse janë marrë të gjallë, janë ne kemi plot raste të tilla që janë marrë të gjallë si në Kralan apo në Mejë që ende nuk janë zbuluar të gjithë prandaj si janë marrë të gjallë, të gjallë po i kërkojmë prandaj do të kishim pas kërkesë sigurisht që të gjitha format, të gjitha mundësitë edhe zonja Natasha dhe të gjithë ata të cilët mund të kenë sens human njerëzor të ndihmojnë në hulumtimin e të gjitha atyre vendeve. A ka vërtetë vende ku ekziston mundësia të mbahen njerëzit e gjallë edhe dyshime tona janë se në bazë të informatave të familjarëve që nuk i dekonspirojnë për shkak dhe arsye të sigurisë që në të vërtetë strukturat ushtarake të veçanta të cilat nuk i përgjigjen as qeverisë as institucioneve mund t'i mbaj gjallë, do të thotë dikush do të thoshte se a është e besueshme, derisa nuk vërtetohet e kundërta dhe e ke informacionin ti nuk mund ta mohosh, nuk mund ta mohosh prandaj në këtë drejtim do të ishte mjaft e mirëseardhur që mandej të marrin informacione të depërtoj. Shikoni edhe ne e kemi thënë vazhdimisht se institucionet qeveritare serbe dhe individët vështirë mund të pranojnë të na japin dëshminë mbi të vërtetën edhe për zbardhjen e fatit edhe për të na treguar për varrezat, vetëm një presion ndërkombëtar mund të na ndihmoj në atë proces, një presion ndërkombëtar i mirëfilltë prandaj edhe prapë i drejtohem bashkësisë ndërkombëtare pa marrë parasysh nivel evropian apo më gjerë të bëhet presion në qarqet atje për të na treguar se ku janë trupat e njerëzve tanë, djemve tanë, familjarëve tanë. Pastaj çka u bë me ata njerëz që u morën të gjallë dhe u dërguan, p.sh. e kemi rastin shumë transparent që në të vërtetë s'mund ta mohojmë, s'ka qenë emër i panjohur, e ka ditë ndoshta edhe ushtari i painformuar ose gardiani ose polici në burgun e Dubravës për profesorin Ukshin Hoti, si në atë gjendje doli dhe ku u dërgua, kah shkoi atëherë ka qenë edhe vështirë të lëvizin njerëzit, e ai u lirua nga burgu e dikush duhet ta mbaj përgjegjësinë, dikush e ka emrin kush ka qenë personi përgjegjës në burgun e Dubravës, e ka emrin, prandaj të kërkohet ai ose rasti i Kralanit. E kemi

majorin Grujiq, majori Grujiq është diku në Serbi, Kralan pikërisht në Kralan ose e kemi njeriun që e ka marrë me emër Bora Joksimoviq e ka marrë për dore djalin e ri 15-16 vjeçar ia ka marrë gjyshin, ai jeton diku në Serbi, toka nuk e ka lëshu prandaj këto gjëra janë një lloj satisfaksioni për ne, prandaj po them në këtë drejtim unë e përshëndes çdo iniciativë e cila do të ndihmonte në dhënien e kontributit. Për komisionin dhe për angazhimet e komisionit nuk po flas, sepse nuk është vendi na ka munguar ligji, deri më tash s'kemi pas ligj, është në punë e sipër hartimi i një draft projekti që besoj që do të del një dokument mbi të cilin do të mbështetemi dhe do të mund të punojmë. Pastaj sa i përket funksionalizimit do të jenë çështje të tjera të cilat do të kemi mundësi t'i debatojmë por po flas për këtë forum, për këtë këshillim që në të vërtetë dhashtë Zoti të jep kontribut në kërkesat dhe në përgjigjet e familjarëve që me të vërtetë kanë arsye me qenë të emocionuar, të prekur dhe kanë arsye me që të pakënaqur, sepse kaluan dhjetë vite, faleminderit!

Bekim Blakaj: zotëri Gjetaj faleminderit shumë për fjalimin tuaj, tani do të marrim pauz dhe debati do të vazhdoj në pjesën tjetër të takimit, Ahmet Grajqevci dhe zotëri Ramadani janë lajmëruar vetë për fjalë edhe Ymer Merlaku, po!

Pauza

Bekim Blakaj: Po fillojmë sesionin e pasdites, shpresoj që keni pushuar, keni pas mjaft kohë që të pushoni. Tani do të vazhdojmë me debatin unë në fakt do të ju kisha lutur që në njëfarë mënyre të fokusohemi më shumë në pikëpamjen e familjarëve të viktimave se cili është qëndrimi i tyre me mënyrën e nxjerrjeve të fakteve, në të vërtetë çfarë nevojë kanë ata në çfarë mënyre të zhvillohet ky proces. Unë më herët para se të shkojmë në pauzë i kam lajmëruar disa pjesëmarrës që kanë pas dëshirë të marrin fjalën, tash do të ia jap fjalën zotëri Ymer Merlakut, urdhëroni zotëri Ymer.

Ymer Merlaku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, quhem Ymer Merlaku vij nga komuna e Klinës, jam nënkryetar i shoqatës për të zhdukur Klinë, prezent e kam edhe kryetarin e shoqatës për të zhdukur të Klinës, Hysen Morina. Luftërat kudo që ndodhin ato lënë pasoja e disa pasoja janë të sanueshme ndërsa disa janë të pasanueshme, lufta në Kosovë ka rrjedh si rrjedhojë e politikës dhe mendoj që mund të zgjidhet kjo çështje politikisht për arsye se sistemi, Serbia me një politikë hegjemoniste shfaruese, gjenocidiale ka shkaktuar luftën në Kosovë por edhe në vise tjera të ish Jugosllavisë. Njerëzit pasuria më e madhe e kësaj bote, njeriu ka vlerë mbi të gjitha vlerat tjera që ekzistojnë, ka vlerë për ata që kanë ndjenja, dhimbje, dashuri, kuptim e ndërgjegje ndërsa për ata që s'kanë dhimbje, ndërgjegje kuptim, për këta si me thonë është krejt normale, e populli serb sa më duket si të ishte një krejt tjetër, një popull që asesi nuk mund të shkëputet nga ato mite mesjetare të veta nga ato politika hegjemoniste, okupuese dhe mbi të gjitha një popull që dëshiron të ketë popuj tjerë të nënshtruar. Ne shqiptarët patëm një fat të zi që jetuam në Jugosllavi, patëm një fat shumë të zi që jetuam dhe këto që nga lufta e kur këto të këqija nuk iu ndanë popullit shqiptarë. Unë mendoj që një popull i cili bëri luftë sikur rasti i Kosovës një luftë të drejtë dhe të mirë që bënë shqiptarët e kjo u kurorëzua edhe ndihmën e aleatëve të botës dhe fitoi Pavarësinë, e fitoi shtetin dhe tash e kemi Republikën e Kosovës e kemi shtetin tonë. Serbia, qysh nga themelimi i ish Jugosllavisë gjithmonë ka pretendu dhe e ka nënshtruar këtë popull duke filluar kështu nga arrestimet, nga rrahjet, nga përjashtimi i njerëzve nga puna, nga marrja e autonomisë së Kosovës e të gjitha këto deri në luftë, në luftën shfarosëse, kjo politikë e Serbisë bëri që Kosova të bëhet shkrumb e hi dhe mbi të gjitha këto i kemi mbi afër 15.000 njerëz të vrarë, të shkatërruar ekonomikisht, njerëz të zhdukur e të gjitha këto i bëri me një qëllim që t'i

sundoj popujt tjerë që ishin këtu. Ne e patëm atë fat të zi që jetuam bashkë 50 vite mirëpo tashti është një realitet tjetër e unë kam edhe katër familjar të humbur e kam vëllain, djalin e vëllait dhe dy djem të mixhës. Po kam edhe të afërm të tjerë mbesa dhe nipa tjerë të cilët u vranë dhe u zhdukën, unë vëllain e kam gjetur ndërsa djalin e tij 16 vjeçar i cili ka qenë së bashku me babën e vet ai nuk është gjetur, dihet se ata janë ekzekutua në Pastasel me 31 mars ku janë ekzekutuar 106 qytetarë, në mesin e tyre 12 persona i kanë shpëtuar asaj masakre. Mirëpo është për çudi që ata 12 persona të shpëtuar asnjëri nuk është thirrur në gjykatë të Hagës që të dëshmoj. Iniciativa e Natashës kërkon që të formon komisione e unë nuk e di si mund të formojmë këto komisione kur ata, kur vetë populli serb nuk e njeh Kosovën, nuk ka kërku falje deri tani asnjëherë, edhe ky popull, ende nuk është Serbia e demokratizuar e unë nuk e di që ende asnjë politikan serb nuk erdh të përkulet nëpër këto varre që janë 900 varreza masive në Kosovë të zbuluara, asnjëherë nuk erdhën ti vizitojnë. Ky popull është i lidhur edhe me kishën e vet, asnjë pop i popullit serb nuk erdhi ta vizitoj asnjë varrezë diku në Kosovë dhe të kërkon falje e këto janë ato çështje që ne jemi shumë larg me këtë popull, këta së pari duhet të ndërgjegjësohen, të kërkojnë falje por njëkohësisht edhe të përgjigjen për veprat e bëme. Ne dimë fort mirë që në Serbi janë ende ato struktura komanduese, ushtarake, policore të cilët i kanë bë ato krime në Kosovë e sot gjinden në pushtet edhe ky popull, ai popull serb atje ende nuk ka fuqi që ata njerëz t'i heq nga regjimi, t'i heq nga pushteti dhe tash nuk e shoh diqysh formimin e këtyre komisioneve, takimet me palën serbe kur ata janë shumë larg realitetit shumë larg kësaj çështjeje, e tjetër thuhet se janë kaq serb të vranë e ne ende nuk e dimë numrin e saktë por mendoj që numri i tyre është i rritur shumë se mbi 280 deri 300 serb të vranë nuk mund të ketë më shumë edhe ata janë vranë në fronte lufte ose janë vranë nga vetë serbët për arsye të ndryshme që s'i kanë kry urdhrat e tyre apo ka edhe raste që këta janë vranë edhe duke plaçkitur por ka që janë vranë edhe në fronte lufte me ushtarët e UÇK-së kuptohet, por ai numër mund të jetë deri në 300 e jo më i madh sikur që i keni bë ju 800 e 1000 .

Bekim Blakaj: Më falni zotër Merlaku a mundemi me u fokusu në atë se në çfarë mënyre mund të ndryshohet kjo gjendje, ju e përmendët që qeveria në Serbi nuk ka ndryshuar kurrëgjë as nuk ka kërkuar falje a besoni, a mendoni që cila kishte me qenë mënyra më e mirë që të ndryshohet kjo gjendje faktike tash

Ymer Merlaku: Faleminderit, kjo gjendje mund të ndryshohet me një presion të madh të bashkësisë ndërkombëtare duke e akuzuar Serbinë dhe duke i marrë të gjitha ato masa të cilat mund të ndikojnë te Serbia që çështjen e personave të zhdukur ta tregoj, ata e dinë, ata i kanë listat, ata i kanë emrat, ata e dinë edhe kush i ka bo dhe në cilat vende janë bë, të gjithë arkivin e kanë se ajo ka qenë strukturë shtetërore, kanë pas hierarki të gjithë ata i kanë ato, por aty mungon vetëm një presion ndërkombëtar. Unë thash edhe më herët derisa janë në pushtet ato struktura të cilat kanë qenë edhe gjatë luftës nuk mund të ketë ndryshim, bashkësia ndërkombëtare ka fuqi po ajo nganjëherë edhe po i përkrah edhe nuk i ka ato sanksione ato masa që duhet ta kushtëzoj Serbinë, unë e shoh që ndan mjete sikur për Kosovën sikur për Serbinë duhet të kushtëzohet se nëse nuk kushtëzohet ajo vazhdon me avazin e vjetër të vet që e ka qashtu, duke i injoruar të gjitha këto çështje. Për formimin e këtyre komisioneve ende nuk kemi bashkëbiseduar me shoqatat edhe më këtë mirëpo unë mendoj që nga komisionet pak ka rezultate, kjo është vetëm një parafytyrim sikur të atyre të iniciativës së kësaj e asaj se kinse po bëjmë diçka për këtë çështje, a kemi mundësi ti bashkojmë shqiptarët e serbët, e unë nuk e di kah ka rrjedh kjo iniciativë e këtij komisioni, nuk e di kush është inicuesi i këtij komisioni për formimin e këtij komisioni apo jeni ju? a ju? apo kjo nga Kroacia nuk e di kush? Nga ka rrjedh nuk e

di por përderisa Serbia nuk ndërgjegjësohet për të gjitha ato të bëme të Kosovës, komisionet mendoj që janë të zbehta dhe nuk kanë efekt, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Merlaku, unë besoj që nëse keni dëgjuar me kujdes zonjën Knadiq në fillim të sesionit të parë deri në detaje e ka shpjeguar se si ka rrjedh ideja për nismën e kësaj iniciative, megjithatë zonja Tershelliq e kërkoi fjalën dhe do të përgjigjet në ndonjë pyetje të juajën.

Vesna Tershelliq: Vetëm në një fjali. Iniciatorët e idesë janë Documenta nga Zagrebi, Fondi për të drejtën humanitare nga Beogradi dhe Qendra për hulumtim dhe dokumentim nga Sarajeva. Në ndërkohë, iniciativën e kanë përkrahur edhe oganizatrat për të drejtat njerëzore, organizatat e familjeve të të zhdukurve dhe viktimave, organizatat e grave nga Kosova, nga Kroacia, nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia. Në Forumin në Kosovë, ky Kolaicion do të formalizohet dhe do të shohim se sa dhjetëra apo qindra organizata do ti kemi në të, dhe ky do të jetë rezultati i këtij procesi që ka filluar në maj të vitit 2006. Pra, qindra njerëz tashmë kanë biseduar, diskutuar lidhur me këtë dhe tani jemi këtu që të bisedojmë edhe me ju, dhe të dëgjojmë mendime të ndryshme lidhur me iniciativën.

Bekim Blakaj: Edhe zonja Kandiq po e kërkon fjalën.

Natasha Kandiq: Plotësisht po pajtohem me ju, zotëri Ymer. Serbia është sjell në mënyrën më jonjerëzore dhe më të tmerrshme, e sidomos në Kosovë. Përndryshe, ndaj të gjitha vendeve fqinje të ish-Jugosllavisë, mirëpo brenda 78 ditëve, në Kosovë, janë kryer krime të llahtarshme. Ne ende nuk mund të presim nga Serbia dhe qeveria serbe që të jetë e vetëdijshme se mu ajo, është ajo qeveri e cila do të kuptoj krejtë atë që ka ndodhur këtu dhe të vij, për shembull, në Suharekë, ose në Klinë. Mirëpo nuk duhet të harrohet se para Tribunalit të Hagës është duke u gjykuar Ivan Millutinoviçit, i cili gjatë kohës së luftës në Kosovë ka qenë Kryetar i Serbisë, që po i gjykohet Nebojsja Pavkoviçit, Vlladimir Llazareviçit, Gjeneralit Ojdaniq. Këta tre kanë qenë gjeneralët të nivelit më të lartë. Llazareviçi ka qenë komandant i Korpusit të Prishtinës, i cili nën kontrollin e vet e ka mbajtur tërë Kosovën. Po i gjykohet Nikolla Shainoviçit, në atë kohë Kryetar i Qeverisë Federative. Ende nuk ka filluar gjykimi i Vllastimir Gjorgjeviit, për të cilin, sipas aktakuzës, thuhet se ka qenë kryesori në organizimin e varrezave masive si dhe për largimin e trupave nga Kosova. Sipas kësaj nuk mund të themi se nuk ekziston kurrëfarë drejtësie për atë që edhe e ka merituar Serbia, e edhe në raport me viktimat. Brenda këtyre ditëve duhet të shqiptohet dënimi për ta. Pra, po gjykohen. Kjo bashkësi ndërkombëtare e ka detyruar Serbinë që t'i dorëzoj, pra, këta njerëz janë tani duke u gjykuar. Në Serbi, tani, po i gjykohet ndihmësit të komandantit të xhandarmërisë, xhandarmëria është formacioni më i madh policor, për krimet e bëra në Suharekë. Do të ishte normale, që në krahasim me krimet e kryera, tani në Beograd të kemi së paku 10 gjykime ndaj policëve dhe oficerëve për krimet e bëra në Kosovë. Momentalisht e kemi gjykimin për Suharekën, për vrasjen e vëllezërve Bytyqi dhe për vrasjen e grave dhe fëmijëve në Podujevë. Kjo nuk është e mjaftueshme. Dhe e tërë kjo falë presionit të bashkësisë ndërkombëtare. Edhe këtë mos e harroni, Serbia është shteti i vetëm në rajon, i cili e ka merituar që ti gjykohet ish- kryetarit të vet. Millosheviçi ka vdekur, mirëpo tani po pritët gjykimi i Ivan Millutinoviçit. Dhe të gjithë gjeneralët, të cilët në atë kohë kanë patur funksionet më të larta në Kosovë, tani do të dënohen me nga 20, 30 apo më shumë vite. Ashtu që është bërë diçka për drejtësinë dhe për të vërtetën. Më duket se është mirë që atë, që vetë faktin se po ekziston, ta shfrytëzojmë dhe ta ndërtojmë më tutje. Nëse do të ekzistoj ai komision i cili të gjitha faktet e mbledhura që i përkasin krimeve të kryera në Kosovë, nëse ai do ti paraqet ato, dhe po ajo shoqëri, ai popull në Serbi, do të ballafaqohet me to, do të jetë i detyruar të dij se çka ka ndodhur në Kosovë. Kjo është

mënyra jonë, mënyra e shoqërisë civile, se si ta ruajmë, si ta tregojmë, si ta prezentojmë atë se çka ka ndodhur. Më besoni, tash në shkurtin e këtij viti, në Beograd, kemi patur Forumin e tretë Rajonal, në të cilin dita e dytë i është kushtuar dëshmimit të viktimave. Atëkohë, atje ka dëshmuar edhe Bekim Gashi nga fshati Tërm, nga komuna e Suharekës, i cili e ka përjetuar personalisht tragjedinë e tij familjare. Atij i janë vrarë nëna dhe katër motrat. Ai sot i ka dy fëmijë të vegjël, dhe ai nuk do të pajtohet me atë, që ajo që ka ndodhur të mos pranohet në ndonjë gjykatë. Ai do të luftojë. Ai dhe familja e tij, kushërinjtë e tij të afërm, duan që të dëshmojnë, ata duan që të jetë e regjistruar njëherë e përgjithmonë se çka ka ndodhur në fshatin e tyre. Pastaj jemi ulur të gjithë së bashku që të bisedojmë dhe të shohim se si të ju ndihmojmë. Atëherë, me Hysni Berishën, kryetarin e Shoqatës së familjeve të viktimave në Suharekë, organizuam mbledhjen e fakteve, bëmë një hetim të vogël. Mandej e përpiluam një padi për kundërvajtje ndaj një gjenerali, nën kontrollin e të cilit kanë qenë njësitë të cilat kanë hyr në fshat, viktimat të cilat e kanë mbijetuar këtë nuk mund ti identifikojnë ata ushtarë, por e dijnë, e kanë identifikuar një polic vendas i cili ka qenë aty. Domethënë e dorëzuar atë padi penale. Duam të luftojmë në këtë rrugë. Le të vërtetohet ky rast para gjykatës. Bekimi dhe familja e tij do ta kenë shembull një baba, i cili ka luftuar për nënën dhe motrat e tij. Ai nuk e ka më askend. Ai dëshiron t'iu tregoj fëmijëve të tij se nuk mund të thotë „Ndodhi çka ndodhi”. Ai do të bëj krejt çka është e mundur që të arrij gjer te një drejtësi. Në këtë aspekt, më së mirë është që të kemi një qëndrim pozitiv, që të mundohemi të bëjmë të pamundurën, që t'i detyrojmë ta tregojnë të vërtetën ata që nuk duan ta bëjnë këtë. Për ata që nuk duan të dëgjojnë, duhet të krijojmë klimën për të dëgjuar se çfarë i ndodhi Bekim Gashit. Ai ka dëshmuar në Forum, në mes të Beogradit. Por, rasti i tij ka qenë specifik edhe për atë se dy ushtarë, të cilët kanë marrë pjesë në vrasjet në Tërm, kanë dëshmuar në Hagë. A e dini përse një ushtar i asaj ushtrie serbe, respektivisht në atë kohë ushtri e Republikës Federative e Jugosllavisë, ka dëshmuar? Sepse kanë shtënë në foshnjën, dhe ai prej atëherë nuk mund të fle, sepse e zgjon vaji i asaj foshnjeje. Dhe për këtë edhe është lajmëruar të dëshmoj në Hagë. E tmerrshme. Edhe ai është vrasës, ai atje ka shtënë, i është urdhëruar të shtie dhe ai këtë e ka bërë, mirëpo në një moment, vetëm nga arsyet e veta personale, ka vendosur të dëshmoj në Hagë. Pas dëshmimit të Bekim Gashit, e kemi lëshuar incizimin e atij ushtari, dëshmitarit të mbrojtur, fytyrën e të cilit nuk e kemi parë, e dëgjojmë vetëm zërin dhe dëgjojmë kur gjykatësi pyet „Ju e dini se kjo që ju e keni bërë është vepër penale. Për çfarë arsye jeni lajmëruar të dëshmoni?”. Atëherë, në këtë ai përgjigjet se me vite të tëra nuk mund të fle, se e dëgjon vajin e asaj foshnjeje, e di se ka marrë pjesë në krim dhe pret që edhe ai të gjykohej, por nuk ka mundur më të hesht. Domethënë duhet të gjejmë mënyrën që ti dalim në krye kësaj çështjeje. Ne nuk jemi pushtet, por secili nga ne mund të bëj diç, me diturinë e vet, me mbledhjen e të dhënave, organizimin e iniciativave të tilla. Ne nuk e kemi fuqinë që ta themelojmë atë Komision Rajonal, por e kemi fuqinë që ta organizojmë mbledhjen e ”1 milion nënshkrimeve”, këtë mund ta bëjmë. Mundemi, si në Prishtinë, në tetor, ta organizojmë një ditë vetëm për dëshmitimet publike të viktimave, e do të thërrasim ndokend nga Kroacia, Bosnja e Hercegovina dhe Serbia, mirëpo, do të dëshironim gjithashtu që ti dëgjojmë edhe viktimat nga Kosova, ashtu siç e kemi dëgjuar Bekimin në Beograd. Dhe atëherë, të gjithë ju që do ti dëgjoni dhe shihni, do ta kuptoni se sa është e rëndësishme për këto viktimat, që dikush po i dëgjon. Ata kanë nevojë që të flasin publikisht për atë se çka u ka ndodhur, dhe të kenë ndjenjën se ajo është e rëndësishme, se do të sjell gjer te drejtësia. Ta lëjmë Serbinë nga ai aspekt politik, me siguri se edhe kjo do të ndyshoj një ditë. Po ne, tash jemi në pozitë që mund të bëjmë diçka dhe që asaj Serbie ti

tregojmë se çka ka bërë ajo polici dhe ushtri. Dhe nuk duhet të harrojmë se Tribunali i Hagës, ka gjykuar ish kryetarin, tre gjeneralë, nën kryetarin e qeverisë, dhe të gjithë ata tani po e presin vendimin e Hagës.

Bekim Blakaj: Zotëri Merlku kisha dashur që të ia jap mundësinë edhe tjerëve se janë lajmëruar shumë për të marr fjalën, ok të lutem sa më shkurtë që të jetë e mundshme

Ylber Merlaku: Kjo thotë që duhet të tregohet atje, të ndihet te populli serb për ato krime që i kanë bë, unë po ju them, po i them dhe Natashës, nuk ka veç ai fëmijë, ndoshta edhe fëmijë i vogël që nuk i din për të gjitha çështjet që populli serb i ka bo, që ushtria e policia i ka bë në Kosovë, jam i bindur atë mos e thuaj se ata edhe janë krenuar ata edhe kanë festuar ata edhe sot festojnë, serbët edhe sot krenohen atje në Serbi për të bëmet që i kanë bë në Kosovë, ata e të gjithë familjet e tyre i dinë, të gjithë dinë, ju populli serb, 50 vjet e ka pas Gjermania të hyn në Kragujevc e ju përnjëherë, ju e keni bë thuajse nuk ka ndodh kurrjë hiq shëtiteni me flamuj të çetnikëve, shëtisin nëpër Mitrovicë nëpër Kosovë, ju ende nuk jeni zhvesh nga ato mite, duhet ti tregosh popullit tënd,...

Bekim Blakaj: Zotëri më falni Sistemi i informimit bën një punë të madhe gjithkund në botë, unë mund të flas për përvojat e mia personale, mediat në Serbi kanë bë shumë gjatë viteve të 90-ta edhe pasi që në fakt e vërteta të mos të del në shesh, është fjala konkretisht për Serbinë dhe unë kam pasur rastin të takohem me shumë njerëz që me të vërtetë nuk e kanë idenë se çfarë ka ndodh në Kosovë, mirëpo kjo është një temë tjetër, unë kisha dashur që të ia jap fjalën zotëriu Ahmet Grajqevci, i cili ka kërkuar fjalën qysh para pauzës, urdhëroni zotëri Ahmet.

Ahmet Grajqevci: Mirë faleminderit Bekim, i përsëndes të gjithë të pranishmit, e përsëndes zonjën Natasha Kandiq dhe e falënderoj për gjithë kontributin që e ka dhënë gjatë luftës dhe që është duke e dhënë pas luftës për krimet dhe gjenocidin serb që e ka bërë në Kosovë, falënderoj posaçërisht për familjen Bogujevci ndoshta do t'ju rrëfej pak meqë kam po jo me ditë, me orë ndoshta me muaj e me vite, ndihma e zonjës Natasha Kandiq për familjen Bogujevci ishte dhe do të mbetet shembull në historinë e popullit shqiptar, pse e them këtë? Tre fëmijë të familjes Duriqi, Bogujevci më falni ishin të plagosur në spitalin e Prishtinës dhe okupatori serb me ikjen nga Prishtina i mori edhe ata tre fëmijë të plagosur ashtu në Beograd dhe kështu një qytetar shqiptar i Kosovës që ishte duke punuar në Beograd bie në gjurmë duke i treguar një mjek se janë tre fëmijë si duket janë shqiptarët të Kosovës po nuk mund të merremi vesh ndoshta i keni parë dhe do ta shihni në filmin dokumentar që e kam bërë për familjen Duriqi dhe Bogujevci. Dhe Haxhiu posa e merr atë lajm nuk e din se kujt t'i drejtohet dhe troket në Kryqin Ndërkombëtar, troket në Kryqin e Kuq të Serbisë dhe kështu i drejtohet zonjës Natasha Kandiq dhe thotë se janë tre fëmijë shqiptarë të plagosur në këtë burg dhe nuk dimë se si të merremi vesh me ta por me Haxhiun, se zonja Natasha Kandiq me siguri se e njeh mirë se ka pasur kontakte të shumta bisedon dhe shkon dhe e falënderoj që me vetë kontributin e saj këta fëmijë i ka sjell në Mançester të Anglisë për shërim dhe i ka bashkuar me baballarët e tyre d.m.th. ky është një falënderim i posaçëm dhe kështu duhet të jenë të gjithë humanistët dhe të punojnë për të vërtetën, se nuk mund të arrihet paqja pa u ndriçuar vërteta, këtë duhet ta dimë të gjithë ne edhe ata në Serbi edhe ata Kroaci dhe ata në Bosnje. Por desha ta them këtë ne në vitin 2001 e organizuam një konferencë "E vërteta dhe paqja" ku deshëm të tregojmë se duhet të hulumtohet e vërteta për të gjitha ato krime kudo qofshin kryer ato, qoftë në Kosovë, qoftë në Mal të Zi, qoftë në Maqedoni, qoftë në Bosnjë, qoftë në Kroaci, pse cekim Malin e Zi dhe Maqedoninë, ne kemi krime të kryera në Kallugjerski Llaz në Mal të Zi dhe është iniciuar procedura

gjqësore e aty vlen të falënderohet zoti Veli Muriqi për këtë kallëzim penal d.m.th. shumica nga ju nuk e dini se atje jnaë kryer krime, shumica nga ju nuk e dini se aty janë kryer dhunime, nejtse ti e din, ti nuk ke qare pa e ditë Bajram, po të tjerët familjarë nuk e dinë, ju të nderuar familjar nuk e dini se në Maqedoni ka varreza masive të shqiptarëve dhe ne hulumtojmë, po si do të hulumtojmë? Ne do të hulumtojmë bashkërisht me iniciativë të përbashkët, me këtë iniciativë me këto komisione të forta, të qëndrueshme dhe në bashkëpunim, përndryshe ne kemi hulumtuar në Maqedoni ndoshta dy javë ditë derisa kemi ardhur te zbulimi i varrit masiv, kishte njerëz që e dinin, e mohonin atë dhe arritëm që t'i zbulojmë, pse duhet të jetë një komision për të vërtetën, këtë e them unë si individ dhe çfarë kam mund nga puna ime e terreni të vlerësoj dhe të shoh nga terreni procesin e punës, e marrim shembull për të vërtetën a duhet të thuhet e vërteta apo duhet të fshihet e vërteta? Komisioni qeveritar serb del me një deklaratë para komisionit qeveritar të Kosovës dhe thotë me urdhrin e prokurorit të Mitrovicës janë ekzaminuar varrezat masive në Izbicë dhe thotë janë marrë për autopsi por për fat të keq e vërteta qëndron ndryshe se ato varreza të cilat janë bartur për t'i humbur gjurmët e krimit nga Izbica janë vendosur në Suhodoll gjë që i kemi gjërat e filmuara 10 orë apo 15 orë nuk e di sa janë, janë vendosur në Bruznik ku kemi dëshmitarë dhe familjarë që i kanë gjetur edhe prindërit e vet aty dhe në Novolan do të thotë a është dhënë e vërteta për ato? Jo! Dihet se e vërteta është që të lypet prokurori se kush e ka dhënë urdhrin dhe pse e ka dhënë pra ka emër edhe mbiemër, kalojmë tani në disa rrëfime t'i bëj kështu që ju t'i kuptoni pak më mirë, në Drenicë. Zonja Natasha Kandiç shumë bukur e cekti aty Shavarinat, Xhaminë e Qirezit a kemi dëshmitarë për Shavarinat dhe a u kry në mënyrë komanduese dhe administrative krimi mbi Shavarinat? Po! Dihet me emër e mbiemër se është kry krimi, por të kërkohet nga institucionet dhe nga vërteta se kush janë ata dhe të deklarohen, kemi shembull e marrim kidnapimin, është kidnapuar Arsim Zogijani me 22.08.1998, është kidnapuar pikërisht para familjes së tij në Prishtinë dhe sot e asaj dite nuk dihet se ku është dhe ku ka shku Arsim Zogijani, kurse dihet se është kidnapuar nga KOS-i i Serbisë dhe është emri dhe mbiemri i personit dhe këtu duhet zbuluar e vërteta, dëgjoni kjo është për t'u zbuluar e vërteta për të bërë presion dhe për të ditur se kush e kapi Arsim Zogijanin dhe rastet tjera. Marrim shembull varrezat masive në Fushë Kosovë, të gjitha janë kryer në mënyrë komanduese dhe administrative, kemi emra dhe mbiemra, kemi njerëz të cilët e kanë bërë ekshumimin në mënyrë komanduese, tash ndoshta do të rrëfen vetë zotëri Shaban Ramadani për rastin e familjes Ramadani, kemi raste të tjera të shumta për shembull njerëzve shqiptarë u ndërrohet edhe identiteti dhe quhen romë dhe a duhet të ekzistoj një komision për të ndriçua të vërtetën që ai mos quhet romë? Po po duhet të ekziston e ne nuk kemi mundësi të hyjmë në Serbi dhe të themi zotëri ky nuk është romë por është tipik shqiptarë, kam për katër djem të familjes Breznishta, familjen Krasniqi nga Breznica të cilat komisioni qeveritar serb i quan ata anëtarë të familjes romë dhe jo vetëm ata po pikërisht ka mjaft të tjerë dhe na përket të mendojmë mirë se na duhet një iniciativë e këtij komisioni për të vërtetën dhe unë mendoj se duhet të jetë dhe pa një debat kështu siç jemi të bashkuar sot këtu, të jemi edhe në Beograd, edhe në Zagreb, edhe në Sarajevë edhe çdo kund, kriminelit duhet t'i thuhet troç se krimi është, e ke bërë ti dhe e kë fytyrën plot gjenocid zotëri! Dhe ky komision unë mendoj se duhet të jetë dhe ju gjithkush e jepni mendimin tuaj për këtë dhe kemi kohë për të menduar, faleminderit, faleminderit shumë!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Ahmet! Tani fjalën do të ia jap zotëri Ramadanit por do të doja të ju lus të gjithëve të fokusohemi më shumë në nevojat e familjarëve të viktimave, cka duhet të bëjmë në të ardhmen për familjarët në mënyrë që t'u kthehet

edhe dinjiteti e më vonëtë mundohet edhe për dëmshpërblim e kështu me radhë, zotëri Ramadani urdhëroni.

Shaban Ramadani: Faleminderit shumë! Unë jam Shaban Ramadani, do të ju flas në emër të familjes sime dhe për tragjedinë e familjes sime e cila është një tragjedi që e ka peshën e vet dhe ka pasojat e veta dhe ka dhimbjen që vetëm ne si familjarë mund ta përballojmë, si mund ta përballojmë dhe si e kemi përballu dhe çfarë kemi bërë ne si familjarë, absolutisht nuk kam bërë asgjë për familjen time, absolutisht nuk jam fajtor që s'kam bërë kurrgjë për familjen time, të gjithë e dimë vitin 1999, çka ka ndodh në vitin 1999, kush duhet të merret me Sërbinë? Kush duhet të merret me një aparat shtetëror kriminal? OJQ-të? D.m.th. shoqatat e pavarura ta mbrojnë Sërbinë e fuqishme, një Serbi që ka armatim jashtëzakonisht të fuqishëm, një Serbi që e ka Rusinë jashtëzakonisht të fuqishme dhe organizatat joqeveritare të kenë kujdes kur të flasin për Serbinë, Serbia është një shtet i mundshëm, një shtet i fuqishëm që sot luan me Evropën, t'i lëmë viktimat e Kosovës, me 1 maj të vitit 1999 në ora 12:15 Serbia bombardon me bombarduesit francez autobusin përplot me shqiptarë ku për fat të keq 35 viktima janë shqiptare, simbolikisht janë dy viktima serbe dhe në atë tragjedi pësojnë 8 anëtarë të familjes sime dhe për fat të mirë mbijetojnë 8 anëtarë të familjeve tjera d.m.th. sot janë dëshmitarë të gjallë dhe sot e asaj dite askush nuk është marrë me atë tragjedi, kush është fajtor për këto sende, kush është përgjegjës për këto sende, a është qeveria e Hashim Thaçit që është formuar pas 7-8 viteve, a është qeveria e atij tjetrit, atij tjetrit? Askush nuk është fajtor përveç se neve familjarëve, o zoti Bajram ne menduam se po krijojmë një shtet demokratik, një shtet të mirë, ku ai shtet do të merret me hallet e njerëzve d.m.th. do të merret me viktimat absolutisht askush nuk u morr me viktimat, institucionet në Kosovë priten që Bashkësia Ndërkombëtare do të merret me të gjitha problemet e Kosovës edhe do t'i zgjidh të gjitha problemet e Kosovës të gjitha nevojat e familjarëve, ne i besuam institucioneve tona, këta ua lanë problemin Bashkësisë Ndërkombëtare. Bashkësia Ndërkombëtare është shumë e vëmendshme dhe shumë e gatshme ta ruaj vetveten dhe t'i ruaj pilotët e vet dhe t'i ruaj njerëzit e vet, për fat të keqin ose të mirin është dënuar një gjeneral francez për të gjitha ato bombardime të qëllimshme ku ka lënë pasojat të tmerrshme, çfarë ka ndodh me viktimat? Njerëzit janë transportua në spitalin e Prishtinës e disa janë transportuar edhe për Serbi, në kohën kur janë fut viktimat në spitalin e Serbisë kanë fol shqip viktimat dhe janë nxjerr prej atyhit viktimat të gjalla jashtëzakonisht të djegur shkalla e katërt e pestë e gjashtë djegie e rëndë dhe janë kthyer në Prishtinë. Iu janë bërë amputime të pjesëve të trupit u janë bërë maltretime, u kanë thënë shqiptarëve edhe ju jeni njerëz edhe ju duhet t'i provoni bombat e NATO-s, jo vetëm na serbët dhe në atë tragjedi ka shpëtuar një fëmijë i vëllait tim që quhet Bislim katër vjeçar, sot e asaj dite askush nuk është marrë me këtë rast, unë i kam qar duart prej njerëzimit, i kam qar duart prej shtetit të Kosovës, falë këtij zotëriut këtu Ahmet Grajqevcit janë këtu sot me juve dhe falë zotëriut Ahmet Grajqevcit jam psikikisht, po ma merr mendja psikikisht taman dhe shteti serb ato viktima i ka përdor si kundër NATO-s, sot e kësaj dite zonja Natasha, e ke babën tem, e ke bundën e babës tem në internetin serb dhe dy vajzat Artën dhe Besën. Sllobodan Millosheviqi në Tribunalin e Hagës i ka qit si viktima serbe pra zoti Bajram me viktimat tona shqiptare Serbia po fiton poena, po e mbron veten dhe e ka mbrojt veten, çka duhet të bëjmë ne tash ta fajësojmë zonjën Natasha Shehu që ka kontribuar diçka, a duhet ta fajësojmë, askujt nëse nuk i duhet një Natasha Shehi mua më duhet një Natasha Kandiq, mua më duhet edhe në Bruksel edhe në Prishtinë edhe në Beograd sepse arsyeja që unë po jetoj dhe mbijetoj është vetëm t'i gjej 5 fëmijët ose teshat e fëmijëve të vëllait tim ose atë fëmijë të gjallë, kushdo le të thotë se kam punuar dhe kam bërë diçka unë si familjarë po du të

rezervohem dhe nuk dua të ju lëndoj, për veten time nuk kam bërë asgjë, më vjen shumë keq që kam shpresu që institucionet tona, njerëzit tanë janë më të vëmendshëm janë më normal se sa ne, ne kemi plotësisht arsye të jemi më të çmendur. Zonja Natasha Kandiq unë nuk e kam mundësinë një lule në kopshtin tim me e mbjellë, pse nuk e kam mundësinë? Sepse frikësohem që do të më del një dorë, një kafkë e njeriut aty, do të gjej sende të familjes sime, nuk ka varrezë masive që nuk kam hy, mund të ju them lirisht se po jetoj në një varrezë masive që quhet Kosovë, ishalla gjeneratat e reja e gëzojnë Kosovën dhe ishalla gjinden të gjithë njerëzit sepse është shumë e nevojshme të kemi varrin e të dashurve tanë. Kemi festa që s'kam mundur të shkoj me bë një lutje për shpirtrat e atyre njerëzve e shumë e shumë sende tjera që për çdo ditë na godasin e na vrasin, edhe një gjë desha të ju them se asnjë shqiptarë në Kosovë nuk është çmendur të kritikoj NATO-n, absolutisht as unë nuk e kritikoj as nuk e kam kritikuar asnjëherë, si mundem të kritikoj një diell që na nxeh, të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe e dimë rëndësinë e NATO-s dhe e dimë që ka bërë shumë mirë, nuk qon peshë një familje e imja absolutisht nuk qon peshë, le të zhduket edhe ajo që ka mbet e imja, por kriminelët duhet të stopohen, a kemi mundur ne me i stopu? Nuk është ma merr mendja për gjenocidin që ajo po e bën edhe sot Serbia, ne mund ta zhdukim Natasha Kandiqin, ne mund t'i bëjmë çka të dojmë, por ajo po e vazhdon diplomacinë e vet, po e forcon shtetin e vet, po i përdor viktimat tona kundër Kosovës, kundër të drejtës ndërkombëtare për me jetu, ne kemi lyp me jetu me e pas një ekzistencë, s'kemi lyp ne me e shkatërru Maqedoninë a Serbinë a Kroacinë?! Çfarëdo nismë e juaja dhe çfarëdo vullneti i mirë i juaji besoj që është pak i vonë sinqerisht i kam qar duart prej njerëzve sinqerisht, më vjen shumë keq që kryetari i shtetit thotë do të bëjmë ç'është e mundur për t'i gjetur njerëzit e zhdukur, për mua do të bëjmë çdo gjë që është e mundur, për mua është do të bëjmë asgjë çka është e mundur të mos bëjmë, nuk kemi lyp ne familjarët që qeveria e Kosovës, policia e Kosovës me shku e me grupu Serbinë, absolutisht nuk e kemi lyp sepse nuk e kanë të mundur por kemi lyp qato kufoma, ato eshtra falë Bashkësisë Ndërkombëtare e vullnetit të mirë të njerëzve me na i kthye e me i varros ashtu si e meritojnë. Me të thënë të drejtën si mund të ju arsyetohem unë si familjar juve me ju thënë kanë bërë institucionet tona, kanë bërë çka kanë mundur, në morgun e Prishtinës janë asgjësuar po asgjësohen 300 mbetje mortore pa asnjë shpjegim, nuk ka Kosova aq tokë sa me i varros bashkërisht, në Suharekë varrosi, varrosi ku të duash, unë do të shkoj atje, e kam nevojë e kam obligim do t'i gjej atje, do të lutem për atë gjë s'ka rëndësi të kujt janë a janë të zotëriut të familjes së tij apo të kujt janë? Si duket ia kemi zbut pak krimin Serbisë, absolutisht ia kemi fsheh 20 kufoma, 15 kufoma, 10 kufoma në mënyrë graduale dhe nëse vjen një komision këtu te na në Kosovë, thotë qomë ku janë njerëzit e zhdukur që janë kthyer nga Batajnica ku janë, ku me i qu, me i thanë që këta njerëz kanë shku me luajt futboll në Beograd, si mundet një inteligjencë, një njeri që të nënshkruaj, ti pranoj kufomat në Kosovë pa kurrfarë fletëlëshimi, pa kurrfarë të dhëne për çfarë arsye është vrarë, si kanë mujt unë nuk e di, unë nuk kam shkollë, jam njeri pa shkollë, unë nuk do ta gjykoj askënd, nuk do ta vras askënd nuk jam vrasës. Në luftë s'kam pas armë as sot s'kam armë, s'më kryen punë kurrgjë absolutisht por do ta vret historia dikush do të shkruan për këto sende, a do të jem unë apo s'do të jem absolutisht s'ka rëndësi, çfarë po nxjerrim nga ky takim, secili prej nesh po e analizon punën vet çka ka bë për njerëzit e zhdukur, këtu po flitet me emër të familjarëve, e falënderoj Zotin që po më len normal, e falënderoj që po më len të ekzistoj në këtë farë çmendurie, absolutisht kurrgjë s'është bërë. Janë ndërruar ADN-të, janë bërë gabime, unë në festë të Bajramit s'kam mundur të shkoj me ata dy njerëz që i kam të varrosur aty me iu përkul sepse e kam ndi veten të ofenduar, sepse ndoshta kush e di

të kujt janë, ndoshta janë të Mitrovicës, ndoshta janë të Suharekës, ndoshta ku ta di unë të kujt janë, por edhe nëse gjinden unë nuk e kam besimin më me i varros njerëzit, kush ka pas nevojë me u marr me këto sene, me këto viktime, në rend të parë është dashtë institucionet tona. Këtu po flitet se dimë, absolutisht nuk dimë asgjë, sa di unë dy vajzat e vëllait tim në internetin serb që 9 vite janë si viktime serbe në Kosovë. Serbia e ka shtetin e fortë, e ka UDB-në e fortë kanë mbledh fotografi, i kanë të dhënat kanë punuar për internetin edhe punojnë, na ka mujt sinqerisht na ka mujt, me viktimat tona, me njerëzit tonë me nipat e mi, me fëmijët e mi, kush është fajtor? Natasha Kandiqi?! A është fajtorë tregoni, unë po i them je fajtorë por nuk është dhe s'mund t'i them zonjës je, ka kontribu për një familje, për një fëmijë nëse ke kontribuar unë ta puth dorën oj zonjë, e qoftë edhe serb qoftë edhe magjup sepse ai është njeri, ka pas nevojë s'ka ditë gjuhë kurrjë s'ka ditë, ka qenë i plagosur pa familje, kush? Mund të jetë edhe fëmiju i vëllait tim në Greqi, Gjermani të jenë adoptuar, të jenë marrë prej këtuhit para nënave të veta se lëne më në kohë të luftës, unë nuk mundem me gjet një derë normale në Kosovë për me bisedu për këto probleme. Do të bëjmë ç'është e mundur edhe u kry kjo konferenca, u kry puna e zgjedhëm problemin, problemi i familjarëve, të zhdukurve, të njerëzve të plagosur, lënduar është dashtë sinqerisht me iu përvjelë duart edhe me e mat secili veten mos me hy nëse nuk je i gatshëm, unë për vete s'kam guxuar në disa sende sepse nuk e kam ndi veten të aftë që mundem me kontribu. A ka një avokat në Kosovë, a ka more zotëri ndonjë avokat në Kosovë, bile një padi me e pas bë ndaj dikujt që 10 vite, kush ka bë padi ndaj kriminelëve që ne i dimë në Fushë Kosovë me emër e mbiemër dhe ka ardh serbi në komunën e Fushë Kosovës ka dal zonja s'po du me i përmend me emra edhe ka dal zonja me fëmijët e vet edhe thotë kqyre Dragani, edhe ka ikë Dragani pesë kilometra pa ndal vrap, polici thotë jo unë s'kam të dhënë, nuk e di kush është ai, çka e di unë kush është ai d.m.th. s'kemi asnjë avokat që punon në mënyrë humanitare në mënyrë njerëzore në Kosovë. Po më jen keq prej zotëriut s'po du me e kritiku zotëriun sepse ai e ka një vullnet të mirë që ka ardh, ndoshta ndien një dhimbje njerëzore që ka ardh s'po du me e kritiku kërkend absolutisht, kërkend s'po du me e kritiku as zotëriun s'po dua me e kritiku ndoshta e meriton me e kritiku, ndoshta do të duhej unë me i thënë gjithçka, të drejtën realitetin, ne e kemi pas një patolog ndoshta me mjete vetanake, ndoshta edhe kafshatën e fëmijës së vet për me e harxhu, me ardh në Beograd, Beogradi nuk është afër dhe tash çka me e kritiku unë zotëriun, unë e falënderoj sinqerisht në emër të familjes time, ka kontribuar për njerëzit për eshtrat e tyre, e meritojnë ata njerëz me u varros në tokën e vet. Zonja Kandiq nëse i marrim 5 pemë dhe i qojmë e i mbjellin në Serbi, në Beograd ato kushtojnë jashtëzakonisht shumë, kushtojnë së pari me i ble ndoshta nuk kushtojnë shtrenjtë por kushton puna, transporti krejt ato sende. Besoj që e dini mirë çfarë ka bë Serbia në Kosovë dhe besoj se për këtë arsye jeni këtu, jo pse ne jemi njerëz të mirë ose pse jemi ne njerëz të dashur ose ku ta di unë, por viktimat nuk flasin oj zonja Kandiq, ato kanë vdek nuk e kanë meritë me i pas eshtrat në Beograd sikur që nuk e meritojnë njerëzit e Beogradit me i pas eshtrat në Kosovë, kanë familje, kanë pasardhës, kanë nevoja ata. Fatkeqësisht në luftë e pësojnë njerëzit e pafajshëm, zakonisht njerëzit e pafajshëm pësojnë, unë ua përmenda më herët doktor Pajën në Beograd, e vetmja arsye që unë do të shkoja ndonjëherë në Beograd është doktor Paja që nuk e njoh, nuk e kam parë por kam biseduar me të, i cili e ka dhënë betimin e Hipokratit dhe e ka mbajtur betimin e Hipokratit dhe u ka ndihmuar njerëzve në kohët më të vështira, në kohën kur janë vra njerëzit me pregushivaq në jastëk, rend janë vra njerëzit në spitalin e Prishtinës, pra si familjar ndoshta do ta kisha zgjatë shumë por nuk po du me ju lodh nuk po du me ju mërëzit, mërëzinë lena neve, ajo na takon neve, ne e përballojmë atë, ju

s'mundeni me e përballuar sepse s'jeni në lëkurën tonë, nuk e dini çka do të thotë të mungojnë krejt anëtarët e familjes, absolutisht nuk e dini, nuk e dini çka do të thotë kur ti e ke një fëmi edhe mendon me ia ble një çokolatë në shtëpi e nuk mundesh me ia ble, sepse të dalin fëmijët tjerë përpara syve ata janë pesë, ka familje që ka më shumë 15, 13 e 16, shumë e vështirë është, jashtëzakonisht e vështirë vetëm Zoti na ka ndihmuar dhe ishalla bekimin e marrin ata të gjithë që e meritojnë me e pas bekimin, ishalla dënimin e marrin të gjithë ata që e meritojnë me e pas dënimin. Kam shumëçka tjetër me ju thënë, shumëçka ju kisha thënë shumëçka ju kisha tregu për qato çka kemi përjetuar, çfarë vrasjesh kemi përjetuar në Kosovë, por të gjithë e dimë dhe të gjithë po ikim prej realitetit, valla ka ardh koha me ju mbështetë për muri edhe mos ia merrni për të madhe axhës Bajram, sepse po hyjmë në lëkurën e tij dhe njeriu ka të drejtë që ndoshta atë që s'duhet me e kritikë e bash qato duhet me e kritikë se kemi ardh në qaso pozite, na kanë premtuar more burrë, nuk e di çka s'na kanë bërë, mashtru thjeshtë na kanë mashtru hajt kalo kjo zgjedhje hajt ajo. Unë i mbaj mend Olivion e Kryqit të Kuq, Marion, unë mbaj mend shumë njerëz unë nuk mundem me jetu në Kryqin e Kuq, unë kam familje kam obligime, u lodhëm dikur duke i takuar njerëzit duke i prit, u lodhëm sinqerisht u lodhëm, kemi punu edhe ne familjarët mos mendoni që nuk kemi punuar. Volfgang Kamerov ka qenë komandues i aviacionit të NATO-s, atë ma ka thënë Marek Antoni Novicki, ndoshta ju lodha e zgjata pak por po du me ju spjegu se jemi munduar me bë diçka dhe ai ka urdhëruar me i bë sendet në Kosovë dhe ia shkruaj një letër atij zotëriut dhe i them o zotëri pse ma bombardove familjen me 1 maj të vitit 1999, kur forcat serbe kanë pas makineri luftarake jashtëzakonisht të madhe ke mundur atë me e bombardu e jo civilët se njerëzit e kanë pas shpirtin në dorë s'kanë pas bukë s'kanë pas shtëpi asgjë s'kanë pas kurrigjë s'kanë pas dhe zotëria këtë kërkesën time ia dërgon shtetit gjerman sepse ai ka shtet dhe e ndjen veten të pasigurt, ka menduar që unë po i bëjë presion atij. Nuk i bëjë presion asnjë njeriu në botë nuk i bëj sepse presioni më ka qit prej shtëpisë, më ka lënë pa familje dhe as shtazëve nuk u bëjë presion, ai një muaj ditë më herët e konfirmoi largimin nga Kosova, më erdhi keq se desha me i shkruajt edhe një letër me i thënë rri rri në Kosovë, shteti gjerman atë kërkesë time ia qoi selisë së NATO-s në Bruksel dhe ata ma kthyen një përgjigje ledhatuese "Kemi ardh në Kosovë, ju kemi ndihmuar e tash ju mirrni me problemet e juaja", 35 Euro deri tash or zotëri që je aty ulur në qeveri nëna ime ka marrë pension që iu kanë vra tetë anëtarë të familjes, një nënë e një serbi në Kosovë që i ka vra 35 shqiptarë i ka marr 40 euro pension, a është e drejtë kjo njerëzore? Nëna ime s'ka pas nevojë me marrë kurrfarë pensioni vetëm po du me ju tregua që edhe këtu po vrasin, po na godasin, nuk mundem më të shkoj nëpër institucione, nuk mundem më të shkoj në qeveri, familjarët që kanë persona të zhdukur kanë problem me KEK-un, kanë problem me ekzistencën, pra nuk është e mirë që po e përmendi këtu ndoshta. Po ju mërzisë me këto sende po njerëzit kanë nevojë të jetojnë të lirë, kanë nevojë të kenë mbështetje të dikujt, unë nuk kam nevojë sepse po punoj dhe po e di ku po jetoj dhe e di që s'mundem dikujt me ia lyp edhe s'mundem me vjedh dhe po merrem me familjen edhe nuk po du me e zgjatë por po dua me ju thënë sinqerisht që familjarët kanë ardh në një pozitë që po ikim prej njerëzve. Unë po iki prej njerëzve sepse po më duket që është i vdekur sinqerisht po të them, kur po i shoh njerëzit duke ecë po më duket që krejt të vdekur janë, po kemi probleme jashtëzakonisht të mëdha, kanë humb më shpresat do të bëjmë diçka, para tri viteve e kam pas një intervistë në varrezat e Fushë Kosovës edhe hatri i asaj vajzës shkova sepse jam lodh më prej intervistave nuk dua më, nuk dua më edhe që nga aty i kam bë lutje qeverisë së Serbisë, i lutem qeverisë së Serbisë të na i kthej eshtrat e njerëzve tanë, pse nuk e bën ministri atë? Kryeministri pse nuk e bën atë punë?! Të

lutem kthenani kufomat se janë tonat, janë njerëzit tanë s'kemi na barut, s'kemi na aviacion s'kemi na kurrgjë edhe s'po dojna me pas për juve, na ktheni eshtrat e njerëzve tanë. Para tri viteve Fransua Stan më ka thënë, kam qenë me një familjarë në një takim të Kryqit të Kuq, thotë po kemi të dhëna prej serbëve se kemi në anën a veriut një varrezë jashtëzakonisht të madhe edhe do të punojmë, tri vite shkuan në pritje, tri vite shkuan mashtrime, s'ka hapje të varrezës e krejt Kosova po më duket varrezë, kërkoj falje që e zgjata por e kam obligim njerëzor me ju tregu pakënaqësinë e familjarëve e mos respektin ndaj viktimave, mua mos t'më respekton askush s'kam nevojë me dal në televizione, s'kam nevojë për kurrfarë beneficioni nga ky shtet por njerëzit kanë mund të varrosen në mënyrë njerëzore sikur që ke varrosja në Bosnje. Njerëzit kanë pas nevojë me pas tretman ata që janë vra kanë ardh në kесе të plastikës si kompira, shembull nuk po mundem, s'po du me e zgjatë por nuk po mundem pa t'i thënë këto sende, a janë fajtores OJQ-të për këto sende, a është Natasha Kandiçi, a është baca Bajram fajtor, kush?! Jena fajtorë sepse na s'kemi bë si familjarë, na është dashtë natë e ditë qeverisë tonë, parlamentit tonë me ia mbyll derën për njerëzit e tanë, na është dashtë atë përmendoren tre rremë që me e mbështjellë me eshtra të njerëzve tanë, me e vetëdijesu këtë milet, këtë qeveri e këto institucione, thjeshtë nuk donë me e ditë çka ka ndodh. Luftë ka qenë edhe kurrgjë kërkujt, sinqerisht historia nuk do të na e fal, ishalla Zoti i bekon ata që punojnë për çdo viktimë, kudo qoftë ajo në Kosovë, Serbi, Mal të Zi, në Afganistan kudo që të jetë viktimë që është e pafajshme, ishalla Zoti i bekon ata njerëz që punojnë edhe kontribuojnë edhe sigurisht se Zoti i shpërblen, ishalla ata që munden me bë dhe s'dojnë me bë ishalla Zoti i dënon në atë mënyrën më të mirë të mundshme, ju kërkoj sepse ndoshta e zgjata pak po shumë mirë po e ndjej veten sepse kam pas presion këtu e s'kam mundur me ndejt këtu duke i dëgjuar bisedat, më është dashtë me dal jashtë me e qetësu veten, tani që po shprehem para jush tani po ndjej veten më mirë, nuk po shpresoj që do të mund të kontribuoj diçka më shumë Natasha Kandiçi, por atë që është e mundur edhe kam dëgjuar për të, e di që është një humaniste e vërtetë edhe për këtë zonjën kam një respekt të veçantë, që kanë gjetur kohë, kanë marrë rrugë me kontribua diçka për viktimat, viktimat kanë nevojë për njerëzit anekënd botës sinqerisht, ju kërkoj falje që e zgjata pak!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Ramadani, në fakt iniciativa për krijimin e një komisioni ka të bëjë me atë që në njëfarë mënyre t'u ndihmohet familjarëve së paku në anën morale mirëpo sigurisht edhe gjetjen e së vërtetës, unë e di mundohem ta kuptoj se çfarë rëndësie ka kjo si familjarë, gjetja e të vërtetës për atë çka ju ka ndodh pjesëtarëve të familjes suaj, jemi pak vonë me agjendë por unë i kam edhe dy folës që janë lajmëruar për ta marrë fjalën qysh më herët është zotëri Lush Krasniçi edhe Xhafer Veliu. Zotëri Krasniçi ju e keni fjalën

Lush Krasniçi: Faleminderit zotëri Bekim, quhem Lush Krasniçi, jam familjarë me viktima, ish të zhdukur, unë këtu në fascikllën tuaj lexova një thënie që nuk është as e serbëve, as e shqiptarëve, as e boshnjakëve, as e kroatëve qenka një emër i panjohur për mua ku po shkruan që çdo qeveri e merr përgjegjësinë për veprat e mira dhe të këqija të paraardhësve të saj, çdo popull për vepra të mira dhe të këqija nga e kaluara e vet për analizë të mëtutjeshme mund të analizojnë çdonjëri nga këndvështrimi i vet, me këta të pranishëm që jemi këtu të nderuar të gjithë për mua me siguri se diku rreth 90% njihemi me ta. Unë mendoj që nga këto debate që u bënë, ndoshta edhe vetë gjendem në vorbull që akoma nuk e dimë qëllimin, programin e këtij komisioni, të cilit akoma nuk i është dhënë emërtimi final, sepse pritet në të ardhmen, ne si familje si anëtarë të familjeve që jemi kemi pësuar vijnë e shkojmë, jetojmë me dhembje, jo emocione shpeshherë po përdoret ka emocione, emocionet kanë një kuptim tjetër,

emocion mund të jetë edhe gëzimi, por vijmë e shkojmë e jetojmë me dhembje shpirti e koke, duke kërkuar të dimë çfarë ndodhi, cila ishte e vërteta kush e ka atë të vërtetë, ku ta gjejmë atë? E nëse e gjejmë si ta bindim të na thotë të vërtetën dhe nëse arrijmë deri te kjo e vërtetë do të ishte më mirë ta pranojmë një të vërtetë të hidhur apo një mashtrim të ëmbël që po zgjat në pafundësi, brenda vendit tonë jemi me në gjendje shumë të rënduar shpirtërore por fatkeqësisht edhe ata që na rrethojnë në sofër, në shoqëri në rrethe më të ngushta e kanë të njëjtin fat, kurse një botë tjetër zhvillohet krejtësisht jashtë nesh edhe ju që jeni këtu dhe një kategori e njerëzve të tjerë kemi një botë tjetër ndoshta nuk është reale ndoshta bota e atyre të tjerëve është reale jo e jona dhe nevojtarë gjithmonë kërkon ndihmë, ndihma vjen nga ai që është më i fortë, e më i fortë në çdo shoqëri është shteti është pushteti, tash 9 vite bëhet Pazar pa hanxhiun që thuhet në gjuhën popullore dhe përfaqësuesit në nivele shtetërore që duhet të na përfaqësojnë dhe zgjidhen pa e marrë së paku një mendim nga dhimbja jonë e pafundme, ne e kemi trajtuar dhe prapë e trajtojmë se këto zgjidhje apo përfaqësime në nivele shtetërore kanë gjithmonë rrjedhë nga politika pra janë politikisht të ndikuar, ne këtu të pranishëm edhe pse nuk jemi shumë, dallimi në qëndrimet tona ose kemi dallime të momentit të cilat me kohë shuhen ose na flet arsyeja, flasim me një gjuhë të kuptimit dhe vetëm ai që ka të përbashkët me ty ai do të kuptojë sepse kjo gjuhë e kuptimit nuk mësohet as në kurse por ajo ndjehet e kuptohet kur duam të kuptohemi, të ndalemi te kjo nismë që nuk është e re është tash disa vjeçare, ne po duam të dimë, të kemi informacione, të kemi të vërteta dhe jemi të gjithë që nga përditshmëria e kuptojmë se për të kryer një punë së pari duhet t'i kemi disa detaje, do të kemi disa informacione e sot, në botën e sotme informacioni është arma më e fortë dhe ne si viktima s'kemi si ti frikohemi të së vërtetës, të vërtetës i frikohen vetëm kryesit e krimeve dhe ne me këto të vërteta të ndërsjella duam që ua trazojmë jetën e tyre plot mëkate që fatkeqësisht akoma jetojnë edhe pse tregohen brenda shpirtit të lirë dhe në jetë luksoze, është edhe e vërtetë dhe të gjithë e dimë se politika ose politikanët nuk kanë dëshirë ta dëgjojnë zërin tonë, arsyet dihen ne këtu nuk jemi mbledhur për ndonjë interes privat ose personal jemi udhëtarë që ta zbulojmë të vërtetën por të vërtetës i dalin shumë armiq dhe pengesa përpara, unë kam identifikuar nga Batajnica 05 dy vëllezërit dhe axhën e tani edhe më shumë më mundon ta di të vërtetën se kush i masakroi ata? Pra nuk më mjaftojnë vetëm eshtrat e varri i tyre, tani gati edhe më shumë më intereson e vërteta, ne duhet ta bëjmë këtë gjë, u kemi borxh atyre që në minutat e fundit nuk mendonin për vete por luteshin që ne të shpëtonim nga vdekja e pamëshirshme andaj askush të mos i frikohet të vërtetës, ai që i frikohet të vërtetës ka ndonjë të pavërtetë brenda vetes andaj para asnjë gjyqi para asnjë kriminelit, para asnjë qeverie nuk guxojmë ta fshehim të vërtetën ngase e vërteta është vetë bekimi nga perëndia, bekimi nga zoti. Unë ju falënderoj të gjithëve dhe pa marrë parasysh se kush ka ndonjë nismë nëse është nismë humane, nëse është nismë që ka si synim të vërtetën unë vetëm mund t'i jap përkrahje morale ose ndonjë mundësi tjetër të ndihmës, ju faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit Lush! Tani do të ia jap fjalën zotëri Xhafer Veliut nga Skenderaji

Xhafer Veliu: Ju përsëritës të gjithëve, jam Xhafer Veliu, jam kryetar i shoqatës “Pengu i Lirisë” Skenderaj, jam familjarë i ish të zhdukurve që kanë qenë, jam dëshmitarë i Shavarinave të ferronikeli të Qirezit të xhamisë edhe vetë e përjetova edhe rrahjen edhe torturat e të tjerëve por edhe mbytjen e të tjerëve ndër sy meje, e përjetova prerjen me thika, e përjetova djegien me cigare në kokë e përjetova në fund edhe vdekjen e tij, unë kujtoj prej asaj që jam ende në ëndërr, unë thelbësisht e kam përjetuar vdekjen, jam dëshmitarë që kam ikë prej më shumë se 17.000 plumbave, e

përjetoj edhe për këta familjarët që kanë ankth, se ankthin e tyre e kam pas edhe vetë që 6 vite, kam prit për djalin tim që ma kanë marrë prej prehrit ushtria e rregullt serbe bashkë me 35 të mitë.

Bekim Blakaj: Hysni Berisha

Hysni Berisha: Faleminderit Bekim, së pari dëshiroj t'i falënderohem zonjës Vesna që ka bërë aq rrugëtim të gjatë prej Zagrebit për me ardh sot në këtë tubim këshillëdhënës, e falënderoj edhe Natasha Kandiçin, e falënderoj edhe Valdete Idrizin, e cila me përkushtim shumë të madh e ka marrë këtë iniciativë që ne si familjarë ose si prindër ose si qytetarë të Kosovës për të gjitha krimet edhe gjenocidi që është bërë në Kosovë gjatë vitit 1998-99, ne kërkojmë as më pak e as më tepër, kërkojmë që të del e vërteta në shesh të dihet si janë bërë ato krime dhe kush i ka kryer ato krime, pa një iniciativë të tillë unë besoj që nuk do të ia dilnim edhe pse unë flas për veten time i abstrahoj të tjerët nuk jam mbështetë fortë as në institucionet ndërkombëtare të cilat në atë kohë kanë qenë e as në institucionet vendore të cilat më vonë jam formu. Mirëpo gjithmonë e kam pas parasysh edhe në mendjen time, me mua prezentë kanë qenë të gjitha ato viktimat të pafajshme të cilat e kanë pësuar gjatë luftës nga gjenocidi i vitit 1999 i Serbisë ndaj më të dashurve tanë, kështu që nuk kam hezituar të trokas derë më derë, nuk kam hezituar të shkoj prej varrit në varr të i hap varrezat vetëm e vetëm për me grumbullu fakte dhe dëshmi për me pas çka me prezentu, për me pas me prezentu edhe në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, por edhe në Gjykata tjera Unë kam arritë ndoshta e kam pas fatin ndoshta vetë puna, angazhimi im, kam pas fatin që të jem dëshmitarë në Tribunalin e Hagës edhe gjatë procesit të Slobodan Milloshevicit, për mua fillimisht kur e kam marrë ftesën për të shkuar në Tribunal të Hagës e kam pas një tremë, kam pas tremë se unë një laik, një qytetar i thjeshtë duhet të ballafaqohem me një kriminel që ka bërë gjenocid në formë institucionale dhe të organizuar edhe sa do të kem unë fuqi edhe forcë që ta dëshmoj të vërtetën edhe të përballlem me atë. Mirëpo duke u nisur nga vetë fakti sepse në momente të caktuara gjithmonë më kujtoheshin ata fëmijë, ato gra të familjes edhe më gjerë edhe kështu e kam fituar një forcë dhe jam ballafaquar. Unë procesin e Slobodan Milloshevicit nuk e kam quajtur asgjë më tepër vetëm se një gotë ujë ta marrësh në det edhe a do të jenë a do të mbulohen të gjitha krimet vetëm me gjykimin e Slobodan Milloshevicit me vijën komanduese, unë nuk kam qenë i kënaqur edhe sot nuk jam i kënaqur sepse për tu përgjigjur për krimet që janë bërë në Kosovë duhet shume e shumë më tepër njerëz të përgjigjen. Kam pas rastin prapë për herën e dytë të jem në dëshmi në Hagë në procesin e Millutinovicit dhe të tjerët edhe këtu e kam fituar atë bindjen që unë jam ai që duhet për hir të gjithë atyre që sot nuk i kemi, ne duhet t'i japim dëshmitë për me i nxjerr para organeve të drejtësisë. Rasti i tretë është duke u nisur nga ajo që Tribunali i Hagës të merret vetëm me atë që populli jonë e thotë peshqit e mëdhenj në atë vijën komanduese e jo për kryesit e drejtëpërdrejtë të krimit, kështu që me dëshmitë që ne i kemi grumbulluar kemi hapur procedurën pranë Gjykatës për krime të luftës në Beograd, për 8 kryes të drejtëpërdrejtë të krimit në Suharekë. E falënderoj Natasha Kandiçin që në këtë proces na ka ndihmuar shumë edhe ne e kemi autorizuar që kjo të na përfaqësoj ne në atë proces, ne edhe kemi shku atje për me e tregu të vërtetën, është edhe ana tjetër morale se si do të jetë dënimi, urojmë që dënimi të jetë meritore edhe në bazë të procesit i cili është duke u udhëhequr nga trupi gjykues, unë nuk dyshoj në atë trup gjykues, mirëpo kam rezervat e mija sepse dëshmitarët e të akuzuarve të cilët kanë dëshmuar gjatë atij procesi kur e di unë se edhe me rrejt nuk është fort lehtë duhet me ditë edhe me rrejt e të gjithë ata dëshmitarë që kanë qenë kah ana e të akuzuarve kanë qenë në një formë bashkë kryes të krimit në Therandë, e edhe të gjitha krimeve që janë bërë edhe më vonë. I falënderoj edhe dëshmitarët të cilët nuk

kanë hezituat edhe pse nuk kanë qenë në lidhje të ngushtë me familjet e viktimave që i kanë ekzekutuar mirëpo për hir të së vërtetës dhe për hir që me e shpreh e ta kuptoj opinionin ato kanë shkuar dhe kanë dëshmuar në Beograd, është edhe rasti i tretë që ndoshta do të jetë shumë shpejtë është rasti i Sreten Gjorgjevicit, me sa di unë ka qenë dashur që të filloj në fund të shtatorit por pse është shtyer nuk e di edhe aty do të jem dëshmitarë, do të jem dëshmitarë edhe për atë çka tha edhe Natasha, për fshehjen e gjurmëve të krimit mirëpo a është i vetmi përgjegjës për të gjitha këto fshehje të gjurmëve të krimit që i ka bërë vetëm Gjorgjevici, unë jam i sigurt që jo! Ne na ngel edhe si familjarë edhe si qytetar të Kosovës qoftë edhe organizatat tjera joqeveritare që janë këtu që edhe në këto momente na janë bashkëngjitur e do të na bashkëngjiten edhe më tepër se të vetmit ne jemi ata që mundemi me shty procesin përpara, të vetmit jemi ata që mundemi me e nxjerrë të vërtetën, unë e di që e vërteta përmes organeve të drejtësisë nuk ka me dal e tëra mirëpo ne nuk duhet të dorëzohemi, ne siç tha Natasha e kemi hap procedurën për masakrën e fshatit Tërne, e kemi hap ndaj një oficeri të lartë i cili ka qenë përgjegjës për zonën e Dukagjinit d.m.th. ka qenë përgjegjës për regjionin e Prizrenit, Gjakovës, Rahovecit e Suharekës edhe ne i kemi ofruar dëshmitë edhe ndaj atij edhe pse ai është një funksionar shumë i lartë në pushtetin e sotëm të Serbisë, është nënkryetar i lidhjes i Partisë Radikale të Serbisë, është nënkryetar i Kuvendit të Serbisë është anëtar i komisionit për marrëdhënie me botën e jashtme të Serbisë megjithatë e drejta qëndron nga ana jonë dhe ne nuk kemi hezituat që edhe ndaj atyre personave të bëjmë kallëzime penale por jo vetëm ndaj atyre por edhe ndaj gjithë të tjerëve që ne në komunën tonë i kemi 17 masakra kolektive duke filluar nga 25 marsi deri me 6 qershor, ne jemi vetëm në fillim të rrugës sepse nuk mundem me u mbuluar të gjitha këto krime që janë bërë në komunën tonë, kemi mbi 500 të vrarë, i kemi edhe sot 140 të zhdukur, kemi shkatërrime, dëbime, dëmtime dhe krejt të tjerat. Nuk mundemi ne me u mbuluar me 2 ose 3 kallëzime penale edhe me thënë e kryem punën, ne kemi edhe shumë punë për të bërë, për të patur sukses dhe për të arritur qëllimet tona të caktuara ne mundemi vetëm në formë forumesh, në forma të bashkimit, të shoqatave dhe institucioneve qoftë regjionale, qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare mundemi me arrit me e zbuluar të vërtetën Ju faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë! Kemi edhe 15 minuta për të debatuar. Ju inkurajoj që të merrni fjalën dhe të nxjerrni idetë tuaja në lidhje me këtë proces me nevojat e familjarëve mirëpo edhe nëse dikush ka ndonjë pyetje ose koment, debati është i hapur ende, zotëri Qerkini urdhëroni.

Bajram Qerkini: Është një pyetje që më dhemb gjithmonë nevojat e familjarëve. Sot po e bëjmë një debat një pjesë e të cilit s'po ma ka ënda hiq, s'kemi ardh me vajtu këtu as me ju tregu sende që duhet të vajtojmë, por kemi ardh me tregu dhe me e dhënë një pëlqim që të formojmë një komision ashtu qysh unë e kuptova se ka me qenë i favorshëm për viktimat por edhe për të pagjeturit. U folën shumë gjëra të cilat i kam dëgjuar s'di sa herë se si shumicë kanë fol shokët e mi që rri më së shpeshti e që mbajmë takime mirëpo disa sende konkrete?! Unë dua kujt të ia them, më keni bindur se duhet të formohet komisioni edhe pse s'kemi asgjë në dorë le të formohet edhe një komision, a thua të ia jap dokumentet këtij komisioni apo dikujt tjetër? Një këshill i 20 asociacioneve nuk ka ku shtyp një regjistër, një këshill familjar i Mitrovicës i kam qe këtu 13 varreza masive në Mitrovicë, që nuk janë të hulumtuara, e kam emrin edhe mbiemrin, datën kur i kanë qu kur i kanë ngarkuar në traktor, citoj kur ka thënë Nebojsja: vozi i ubaci na onaj grob gde si bacio one druge, para 15 qytetarëve, kujt tash t'i them? Juve? Subhije Sylejmani e ka lënë një vajzë e cila nuk din me fol, me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar e kanë pa se është lind, e kemi hulumtuar nuk është

gjetur, kërkend s'ka lënë prapa është e copëtuar para derës së shtëpisë dhe Bllagoje Jakshiqi e ka heq prej vendit, në shtëpi të Eminës është bë krimi edhe dhunimi, janë bë edhe shkarkime të femrave të cilat kanë në muajin e VI-të dhe të VII-të, me emër e mbiemër i kemi njerëzit i kemi treguar, i kemi thirr i kemi thënë, nuk mundem me dal te shtëpia jeme 200 metra nuk është larg varri masiv, është Suphija edhe Salih Zasella, s'dua të flas për Beograd, s'kam fuqi unë të flas për Beograd, unë po flas për prag të shtëpisë po them kqyre ku janë njerëzit, kqyre ku po më sillen te xhamia, kqyre ku i kam në mëhallë të Kërveshve, kqyre ki i kam në mëhallë të boshnjakëve edhe po më shpallin përditë luftë edhe s'po mundem kurrëgjë me bë. Tash vjen pyetja çka ju familjarët propozoni që me shku ky problem përpara, çka na formojmë, çka na mundemi me bë? A e japim pëlqimin për me u formua një komision? E japim! Kush është iniciator s'po më intereson bëni çka të mundeni, por s'ua dhashë besën e Zotit se s'keni me bë send mbi këtë tokë deri sa s'keni bë deri më sot edhe mos të flasim veç fjalë por t'i kthehemi vetvetes çka mundemi me bë? A po don dikush presion, neve na ka premtuar edhe UNMIK-u edhe KFOR-i, na ka premtuar edhe presidenti para 30 gushtit, siç tha edhe një dashamir i jemi, kemi me bë çka mundemi me bë edhe asgjë, unë e di se Hysni Berisha shpeshherë e ka thënë në takimet tona se të gjitha dosjet janë në Beograd, për çdonjërin edhe nuk është punë për e shti njerëzit me na e kthy bile dokumentacionin. Është e pamundur që 23 vetë me u marr në Mitrovicë me emër e mbiemër, me njeri edhe plus asaj me kualifikim, 18 me fakultet e mos me e dit ku janë ?! S'po e di ai komandanti që i ka marrë ku janë a?! Është shumë e pamundur! Qysh me e gjet të vërtetën? Me kënd në komision dojmë me lyp ne ata në qoftë se e duam të vërtetën? Prej kujt? S'ka kush që e shtyn qysh është vendimi në fillim ashtu edhe në mbarim, pa një forcë shumë të madhe në krye në peshqi të mëdhenj, Serbia din me e bë njeriun majmun e me e mbajt s'di sa e krejt bota mos e ditë ku është po edhe atë tjetrin e s'po din me ma mbajt mua djalin 13 vjeç, atë tjetrin 5, vajzën 6 javë, tjetrën 8 javë edhe tjetrën 8 vjeç ?! Unë besoj qind për qind që ata ose i kanë asimiluar, i kanë përvetësuar se s'ma merr mendja që i ka ra thikë atyre fëmijëve që i ka marrë në mëhallën Kërvesh, a është e vërtetë, a i kemi emrat? Po! Bile bile edhe dy shqiptarë i kanë ndihmuar Çedës, Çedo Bozhoviqit, janë edhe emrat e tyre, unë e marr shembull edhe librin në Kaçanik që ka dal me emra ashiqare, ai hoxha ka thënë qe ky shqiptar ka faj, qe ky i i ka ndihmuar, ky shqiptarë i ka marrë , plotësisht pajtohem kush çka di të vërtetën e kemi në letër, kurrë mos u tremb prej të vërtetës, nuk trembem prej të vërtetës. Tha Alush Krasniqi ai që trembet prej të vërtetës është kriminel edhe vërtetë është ashtu! Ai që trembet prej të vërtetës nuk vyen kurrë kurrëgjë, për 20 vjet në i hangsha burg kam me fol për të vërtetën, mirëpo kam me thënë me dokumentacion edhe kam me e thënë m njerëz që vijnë për çdo ditë, të kam thënë është kështu kështu, pash zotin thotë a ka përgjigje? S'ka përgjigje! Doktor Arsim Gërxhaliu s'di a shkoi apo është këtu? Më ka pranuar kam punuar dy orë me të, 90% kanë qenë familjarët më ndryshe, ne nuk jemi as të informuar mjaft, neve na ka thënë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, më falni a e lëmë? Na ka thënë Kryqi i Kuq Ndërkombëtar kur të bëhet dialogu s'ka me u përmend politika, kam marrë pjesë Veljko Adallovici e ka përmend edhe e ka thënë, unë kam qenë qekaq ushtarë numri s'po më kujtohet, me e pastruar terrenin pas lufte, kam gjet kafshë të ngordhura por edhe njerëz të vdekur, ku i kanë lënë njerëzit? Nuk ka treguar, kemi qenë 25 shqiptarë, 13 serbë kur i është bë pyetja ai ka thënë nuk më keni kuptuar se nuk kam thënë ashtu kam gjet kafshë të ngordhura, por ke thënë edhe njerëz more, hajde unë qenkna tranu, unë jam familjar s'jam normal po këta doktor-profesorët? Ishin njerëz! Kryqi i Kuq ka thënë çka të mendojnë, që përzihet në politikë tërhiqemi, nuk po tërhiqem, se më ka thënë kam pas rast me biseduar me ta, veç në Kosovë edhe uji ish

politikë! Atë minutë që na përzihet politika ju kisha lutur organizatave humanitare, komisioneve çfarëdo të jenë në atë minutë që punoni me politikë dhe me tradhti neve na keni marrë në qafë edhe më tutje. Të kam thënë në zyre po të them edhe këtu t'u kisha lut politikave të atyre njerëzve që kanë bërë krime ikju, ikju se je i ri se ke me më këndu rahmet se ndoshta unë se gjej as djalën as qikën as ato e ki me thënë se seriozisht ka me të djeg më zi se mua edhe po na shpallin përditë luftë edhe po na thonë përditë se kemi me hup edhe është drojë, që sidomos në Mitrovicë prapë ka me pas të humbur, kërkoj falje, po një dokumentacion që desha me ju thënë emrat e kriminelëve të Mitrovicës dihen, besoni që këta emra iu kanë dhënë Jusuf Muezinut, prokuro dy vjet pas lufte, s'ka guxuar më i marrë ka thënë qoni tek ndërkombëtarët, kur i kanë qu te ndërkombëtarët mos me i pas marrë ne me i bërë fotokopje kishin me u humb këta por ka dashtë Zoti i kemi fotokopjuar edhe i kemi në shoqatë, i kemi të vërtetat, i kemi dëshmitarët, kush është ai që mundet me e shty problemin, urdhëroni kemi dokumentacione për me e shty problemin, për kesi lloj biseda, për me fol kështu vetëm të them diçka, s'kemi nevojë, as s'kemi me formu komision, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Qerkini! Faleminderit edhe për këshillat tuaja, mirëpo jo absolutisht s'ka të bëjë me politikë çështja e kësaj nisme por sidoqoftë ju më keni pranua në zyrën tuaj dhe shpresoj që këto takime do t'i bëjmë shumë më të shpeshta dhe të konsultohemi për gjithçka, prandaj nisma për organizimin e këtyre konsultimeve ka qenë që të bashkëpunojmë në nivel tjetër dhe të kemi bashkëpunim sa më të ngushtë me njëri tjetrin, tani fjalën do të ia jap zonjës Natasha Kandiç.

Natasha Kandiç: Unë po e pyes veten se apo kuptohemi? Ne po flasim për Koalicionin. Koalicionin, rrjetin e madh të organizatave, shoqatave bile edhe individëve të cilët mendojnë se gjykimet për krime të luftës nuk janë të mjaftueshme që të vërtetohen faktet, dhe se nevojitet edhe ndonjë mekanizëm tjetër, siq i kanë formuar edhe shoqëritë tjera. Si për shembull Timori Lindor, Sierra Leone, Afrika Jugore. Domethënë se na duhet edhe komisioni për përcaktimin e fakteve i cili do të ketë funksion hulumtues, i cili do të ketë mandatin dhe fuqinë që ti thërret edhe përfaqësuesit më të lartë qeveritar, që të japin deklaratat e tyre. Sipas kësaj iniciative, Koalicioni do të ishte ai i cili do të kërkonte nga qeveritë që ta themelojnë komisionin. Ne, si shoqata, si organizata për të drejtat e njeriut, organizata të të rinjëve, etj., do ta përbënim atë Koalicion, do të përkrahim këto konsultime, do të sqaronim dhe ftonim njerëz nga shtetet tjera, siq do të bëjmë edhe për këtë Forum, ku edhe do ti ftojme anëtarët e komisioneve nga Argentina dhe Maroko, që ata të tregojnë se si kanë vepruar, të dëgjojmë nga ata, të cilët tashmë i kanë kaluar të gjitha këto. Mirëpo, ne nuk e kemi atë fuqi që ta themelojmë komisionin, dhe nuk do të ishte mirë ta bëjmë.. Ne do të kërkojmë që të formohet një trup special, i cili do të bëjë përzgjedhjen e anëtarëve të atij komisioni, kërkojmë që shoqatat e viktimave të kenë përfaqësuesit e vet, po natyrisht se aty duhet të vijnë edhe ekspertët të cilët dijnë ti udhëheqin punët hulumtuese dhe vet hulumtimet. Ajo, për të cilën do të diskutohet në Forum, është se së pari do ta prezentojmë atë koalicion. Koalicioni, janë ato organizata, ato jemi ne dhe ju, është secili i cili mendon se na nevojitet dhe është i rëndësishëm, secili që mendon mendon për atë ardhmëri, secili që mendon se gjeneratave të ardhme duhet ti lëjmë një trashëgimi në të cilën ka krime, por ka edhe fakte për ato krime. Për sa i përket dokumentacionit, në këtë moment, shikoni, dokumentacionin e kanë shoqatat e viktimave, organizatat për të drejtat e njeriut dhe të cilat merren me dokumentime, e kanë prokuroritë, bile edhe KFOR-i i ka. KFOR-i është ajo polici ndërkombëtare (transkript), dhe ekipet e shumta mjeko-ligjore (forenzika) janë këtu që nga viti 1999, kanë punuar dhe një numër i dokumentacionit edhe ka dalë jashtë Kosove. Por, ende ka shumë dokumentacion, dhe e gjithë ajo një ditë duhet t'i dorëzohet atij Komisioni

Nacional, i cili do të merret me marrjen e deklaratave dhe me hetimimin e rasteve të caktuara. Domethënë, do të japim edhe ne dokumentacionet tona të shumta, ekzistojnë edhe organizata e shoqata të ndryshme të cilat posedojnë të dhëna. Shoqata nga Suhareka/ Suve Reke ka shumë të dhëna të rëndësishme. Kush ka më shumë të dhëna për atë se çka ka ndodhur në Qirez/ Ćirezu, dhe si janë marrë 35 të mitur nga Xhafer Veliu? Domethënë, sa i përket atij dokumentacionit, le të presim nja dy vite të filloj të funksionoj komisioni e në ndërkohë ta ndërtojmë koalicionin dhe të bëjmë atë presion që ne... Siq thotë Lushi, nuk na mjaftojnë vetëm eshtërat, por duam edhe faktet. E duam të vërtetën, drejtësinë, e duam reparacionin për familjarët e viktimave dhe për viktima. Në të gjithë botën organizatat për të drejtat e njeriut dhe shoqatat e viktimave, janë më aktive kur janë në pyetje faktet. Ekziston edhe një mënyrë tjetër e cila mua më pëlqen shumë, më duket shumë e rëndësishme. Dhe, ne nga Fondi për të drejtën Humanitare, kemi marrë një pjesë nga përvoja e tyre. Argjentina është një vend i jozakonshëm, larg nga ne, por mu për shkak të represionit të huntës ushtarake, ka patur me mijëra të zhdukur, më se 800 fëmijë të zhdukur, edhe prindërit e të cilëve janë të zhdukur, kështu që gjyshet e tyre pastaj kanë formuar shoqata për të tentuar që të gjejnë të dhëna për fatin e atyre fëmijëve. Dhe është paraqitur diçka shumë e tmerrshme. Këta fëmijë janë marrë nga nënat me rastin e lindjes, nga ata të cilët pastaj i kanë vrarë nënat e tyre e pastaj i kanë mbajtur këta fëmijë në familjet e tyre, iu kanë ndërruar emrat dhe këta fëmijë sot nuk e dijnë se nga e kanë prejardhjen. Për fatin e 200 fëmijëve, gjyshet e tyre kanë arritur që gjatë këtyre viteve, të mbledhin të dhëna dhe përmes gjykatës të kërkojnë kthimin e këtyre fëmijëve. Në Argjentinë, më së tepëmi kanë qenë të angazhuara organizatat për të drejtat e njeriut. Ato kanë lobuar për themelimin e atyre komisioneve, por, gjatë tërë kohës që kanë zgjatur ato konsultime, gjersa ai komision nuk është themeluar, ato vazhimisht kanë dorëzuar padi penale kundër oficerëve të huntës ushtarake dhe policëve, të cilët kanë qenë pjesëmarrës në këto krime. Dhe prej aty është krijuar një lëvizje e madhe për të drejtat e njeriut, e cila ka paraqitur me mijëra padi penale dhe që ka patur ndikim të madh, pasi që ka grumbulluar dokumentacion jashtëzakonisht të çmuar para se të formohej komisioni. Natyrisht, ai kryetari, kryetar i parë demokrat, Alfonsini, pas disa vitesh e para skadimit të mandatit, është ndërruar, disa gjeneral kanë qenë të falur. Sot, në Argjentinë, përsëri është ngjallur ajo lëvizje për të drejtat e njeriut, dhe sot, në Argjentinë prap po gjykohej, dhe prap po veprojnë organizata të ndryshme në përgaditjen e atij komisioni që më në fund t'i paraqes të dhënat dhe faktet mbi përgjegjësinë e atyre të cilët kanë kryer krime, e edhe të sjellin një program për reparacion për familjet e viktimave. Dhe, në këtë aspekt, unë kam një propozim, më duket se do të kishim mundur, dhe për 35 fëmijë, unë do të thoja fëmijë, të cilët janë marrë nga xhamia në Qirez/ Ćirezu, dhe për disa raste tjera... ne tash kemi bërë, ende nuk ka përfunduar, draftin e asaj padie penale për vrasjet në burgun e Dubravës/ Dubravi. Kemi përpiluar dhe kemi dorëzuar padin për vrasjen e fëmijëve dhe grave rome në një fshat të vogël te Zvorniku dhe kjo është një mënyrë e mirë e presionit. Kjo nuk është aq e lehtë, e dini, të mblidhen të gjitha të dhënat dhe të ketë dëshmi, por me të vërtetë ia vlen, dhe ne me këtë tregojmë se duam, se duhet, dhe se kjo është obligim i yni për të bërë gjithëçka tëmundemi për të ardhur gjer te e vërteta faktike. Kështu që, ja këtë kam dashur t'ia them zotëri Qerkinit. Pak më ka pikëlluar, e ka thënë këtë disi në një mënyrë pajtuese, thuase nuk po pret asgjë, por nëse kështu mendojnë të tjerët, ai u bindet. Ju keni kohë ende. Ende, të gjithë presin nga ju që të angazhoheni, që të mund të bëni diçka dhe të prisni që ajo drejtësi të vihet në vend. Por, nëse ne të gjithë heshtim dhe pa bërë asgjë presim që ajo drejtësi të vie, atëherë ne nuk do të arrijmë gjer te ajo, pasi që ka më shumë nga ata të cilët nuk dëshirojnë që

të arrihet drejtësia, e për këtë ne duhet të jemi të organizuar, më të fuqishëm dhe të themi ” duam që të gjithë të dënohen; e dijmë se nuk do të dënohen të gjithë, e duam komisionin i cili do të vërtetoj të gjitha ato, të paraqes dhe të shënoj njëherë e përgjithmonë në histori, që askush të mos ketë mundësi të falsifikoj”. Kjo është ajo që ne mund ta bëjmë dhe në bazë të të cilës do të sigurohemi se ashtu edhe do të bëhet.

Bekim Blakaj: Po më duket që në një mënyrë të natyrshme jemi fut në sesionin e fundit të këtyre konsultimeve, d.m.th. fjalët përmbyllëse unë do e kisha pyetur zonjën Vesna Tershelliq a ka të shtoj diçka?

Vesna Tershelliq: Para së gjithash, ju falenderoj për të gjitha fjalimet, brengat, propozimet. Se kjo punë, që po e bëjmë ne, ka një milion hapa dhe Forumi në Prishtinë/ Prištini, për të cilin po përgaditemi, shpresoj se do të jetë një shtytje për prokurorët dhe hetuesit. Shumë është vështirë që gjithnjë, nga fillimi, të përsëritet se çfarë ka qenë krimi i cili ka ndodhur, të përmenden edhe emrat e viktimave dhe të atyre të cilët kanë qenë prezent në vendin e ngjarjes, të atyre që kanë kryer krimet, të cilët kanë ngarkuar trupat, shtënë, të cilët kanë varrosur ndokend. Por, kjo është mënyra e vetme, është e vetmja mënyrë që të themi prapë edhe në opinion, para mediave, dhe ti themi prokurorëve, edhe hetuesve, edhe komisioneve, edhe, thjeshtë, të përballemi me atë se, ndonjëherë, janë të ngathët. Dhe kur, kështu, të kalojnë shumë vite, e këtu u bënë edhe 9 e 10 vite qysh se kanë ndodhur disa krime, e në Kroaci kanë kaluar edhe 17 vite që nga kryerja e disa krimeve, e ende janë në fazën fillestare, ende policia nuk e ka kryer punën e vet, e lëre më që këto të arrijnë gjer në prokurori. Dhe mu për këtë, unë besoj se kjo iniciativë dhe ky koalicion që do të formohet për komisionin rajonal, është vërtetë hap konstruktiv. Ne nuk mundemi ta dijmë se si do të reagojnë qeveritë por, ne mund të kërkojmë parreshtur që të hetohen krimet, të paraqiten paditë dhe gjithashtu të japim më shumë energji në atë që të themelohet Komisioni Rajonal, në të cilën viktimat do të kenë rastin që të flasin për atë se çfarë u ka ndodhur, dhe, të kërkojnë nga trupat hetues të bëjnë më shumë, dhe, që gjykatat të jenë në gjendje që të procedojnë më shumë raste, e, të gjykojnë më shumë kriminel. Kështu që më të vërtetë unë besoj se në këtë Forum do të jemi në numër sa më të madh që është e mundur, dhe që së bashku të ngrisim zërin tonë në opinion që të gjykohet numër sa më i madh i të dyshimtëve, dhe të filloj ky Komision Rajonal në mënyrë, që sa më shumë viktimat të fitojnë mundësinë të tregojnë për ato që u kanë ndodhur. Çfarëdo që të bëhet, as për së largu, nuk do të jetë e mjaftueshme, as për së largu nuk do të mbuloj të gjitha krimet që janë bërë. Fatkeqësisht, kjo është kështu, dhe është vërtetë e vështirë të jetohej me këtë, por, jam e mendimit, se kur punojmë së bashku, atëherë edhe do të na dëgjojnë më tepër. Edhe se është e rëndësishme që, për krimet e kryera në Kosovë, të dëgjohej jo vetëm në Kosovë por për këto krime të dëgjohej edhe në Kroaci, dhe të dëgjohej për to edhe jashtë hapësirave të këtyre shteteve tona post- Jugosllave. Dhe, siq e tha edhe Natasha, të shënohen dhe të mbeten për ato gjeneratat të cilat as që kanë lindur ende. Unë, besoj se kjo është mënyra më e mirë, se përcaktimi i fakteve dhe thënja e së vërtetës, është më e mira mënyrë që të pengohet ndonjë gjakderdhje e ardhshme. Edhe për këtë arsye edhe po e bëjmë dhe le të përpiqemi që ta përkrahim njëri tjetrin për të vazhduar të punojmë. Ju falenderoj.

Bekim Blakaj: Pasi që nuk e kemi përfunduar zyrtarisht debatin, në rregull mandej do të na drejtohet zonjusha Valdete Idrizi, urdhëroni zotëri Haki.

Haki Kasumi: Unë në fjalën time për herë të dytë dhe në njëfarë forme të them ashtu në formë konkluzioneve të këtij, kësaj konsulte të cilën me të gjitha hezitimet tona, dikush më shumë e dikush më pak e konsideroj se kemi bë hapa përpara dhe kemi arrit të sqarojmë çështje, do ta kisha një koment gjegjësisht një kërkesë që komisioni

eventual i cili do të formohej të merr përsipër dhe të ketë në programin e vet të punës që të punoj në ngritjen e një gjykate speciale në Kosovë dhe që aktivistët nga Serbia të bëjnë përpjekje ta përhapin të vërtetën për Kosovën dhe të bëjnë përpjekje ta kuptojnë dh ta pranojnë realitetin e ri, ngase me gjykatën ekzistuese ose me proceset që zhvillohen në Serbi të jeni të sigurt se asnjë milimetër kjo çështje nuk do të shkoj përpara, shqiptari i vetëdijshëm njëherë e përgjithmonë e ka shlyer nga ndërgjegjja dh vetëdija e vet besimin në drejtësinë serbe, ajo për shqiptarët e gjallë të moshës madhore në Kosovë nuk ekziston prandaj për hesapin tim dhe të shumicës absolute të shqiptarëve, ndikimet e krimeve të bëra në Kosovë që organizohen dhe mbahen në Serbi ato janë farsa dhe për ne të papranueshme si pjesë dërmuese e shqiptarëve dhe familjarëve por edhe e aktivistëve shoqatave, lus Natasha Kandiçin dhe aktivistët tjerë që ta përfshijnë në program të komisionit gjithsesi ngritjen e gjykatës speciale e cila do të kishte zhvilluar gjykime së paku më të drejta, nuk po them se drejtësi absolute konsideroj për njerëzit për intelektualët nuk ka por do të ishin ato gjykata më të pranueshme dhe në interes të çuarjes përpara të procesit të ndriçimit dhe të argumentimit e grumbullimit të fakteve për krimet e bëra në Kosovë, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Kosumi! Në fakt duhet ta kemi parasysh se krijimi i një komisioni të tillë kërkon edhe kohë shumë më të gjatë, dikush sot e tha se jemi tek në fillim të këtij procesi d.m.th. kjo është një nismë për ta sensibilizuar shoqërinë civile, opinionin publik e kështu me radhë që të bëhet presion në qeveritë e vendeve të rajonit për krijimin e një komisioni të tillë e mandej për mandatin e komisionit, unë besoj që është shumë herët të flitet tani mirëpo, sidoqoftë faleminderit për propozimin tuaj! Tani do të ia jap fjalën zonjushës Valdete Idrizi si koorganizatore e konsultimeve, urdhëro Valdete.

Valdete Idrizi: Më vjen shumë mirë për shumë gjëra që u thanë, po ndihem sot shumë mirë, tha shumë mirë edhe zoti Kasumi, mendoj që kemi bërë edhe një hap përpara edhe atë çka pata me të vërtetë dëshirë me bërë deri në fund të ditës me të vërtetë ishte që t'i ndajmë të gjitha ato dilema, të gjitha ato brenga, të gjitha çka i kemi, mendoj se gjithë së bashku se secila dorë që na ofrohet për bashkëpunim duhet me e marrë, duhet me e respektuar sepse vetëm në atë mënyrë koordinohemi mirë nëse bashkëpunojmë mirë, nëse informohemi mirë, vetëm në atë mënyrë mund t'i plotësojmë ato boshllëqe të cilat kanë mbetur tërë këto vite, mendoj që kurrë nuk është vonë që të punohet në mënyrën më të duhur edhe shpresoj edhe besoj dhe unë jam shumë optimiste që edhe Forumi i IV-të d.m.th. në fund të tetorit që besoj që ju të gjithë do të jeni pjesëmarrës aty, do të jetë njëkohësisht konstruktiv qysh ka qenë edhe ky konsultim e neve normalisht kuptohet pritet të bëjmë edhe disa konsultime me disa organizata të të drejtave të njeriut, të cilat kanë shpreh interesim që t'i bashkëngjiten edhe një diçka që u përmend pak më herët, nënshkrimi i një milion, mbledhja e një milion nënshkrimeve për këtë iniciativë, unë mendoj që nuk është problem shumë i madh, ka pas mendime të ndryshme që në formë të fushatave të ndryshme të mbledhen, në formë të rrjeteve tjera që veç ekzistojnë mirëpo gjithëherë emëruesi i përbashkët është bashkëpunimi, kështu ju falënderoj edhe njëherë dhe ju dëshiroj drekë të këndshme edhe shihemi në forum, faleminderit!

Bekim Blakaj: Në fakt mua më s'më mbetet kurrëgjë tjetër të them, gjithsesi do ta përsëris për herë të tretë, unë besoj që këto konsultime kanë qenë shumë të suksesshme dhe shpresoj, mendoj që ky ka qenë vetëm një fillim i bashkëpunimit të organizatave tona dhe shoqatave. Dua të ju falënderoj edhe njëherë të gjithë që keni ardh në këtë numër, të ua jap një informacion të shkurtër, ata të cilët kanë udhëtuar jashtë Prishtinës ju lutem që të lajmërohen te kolegja ime Diana për refundimin e

harxhimeve të transportit dhe ju ftoj që të kemi një drekë të përbashkët menjëherë tani në restaurant, ju faleminderit edhe njëherë!